



---

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

2021  
Raport Vjetor

---

© 2022

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare**

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa: Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10, Tiranë

Tel: +355 4 2251 355/6

Faks: +355 4 2250 686

E-mail: [amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al)

URL: [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)



<b>Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv</b>	<b>5</b>
<b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare</b>	<b>7</b>
<b>Bordi i Autoritetit</b>	<b>8</b>
<b>Përmbledhje Ekzekutive: Ngjarjet kryesore të vitit 2021</b>	<b>9</b>

## **Kapitulli 1**

<b>ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE</b>	<b>12</b>
1.1 Tregu i Kapitalit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	12
1.2 Tregu i Sigurimeve	16
1.3 Tregu i Fondeve të Pensioneve Vullnetare	18

## **Kapitulli 2**

<b>AKTIVITETI MBIKËQYRËS</b>	<b>19</b>
2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	19
2.1.1 Pozicioni Financiar	19
2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	24
2.2.1 Pozicioni Financiar	24
2.2.2 Inspektimet	32
2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve	33
2.2.4 Provigjonet Teknike	35
2.2.5 Risigurimet	38
2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit	40
2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar	43
2.3.1 Pozicioni Financiar	43
2.3.2 Inspektimet	47

## **Kapitulli 3**

<b>AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES</b>	<b>49</b>
3.1 Rregullimi i Tregut të Kapitalit e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	49
3.2 Rregullimi i Tregut të Sigurimeve	51
3.3 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar	53
3.4 Licencimi dhe Qeverisja	56

3.4.1. Tregu i Fondeve	56
3.4.2 Tregu i Kapitalit	60
3.4.3 Tregu i Sigurimeve	62
3.5 Masat Mbikëqyrëse dhe Administrative	65

## **Kapitulli 4**

### **PROCESET INTEGRUESE E BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL 68**

4.1 Proceset Integruese për Tregjet nën Mbikëqyrje	68
4.2 Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	70
4.3 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar	71
4.4 Projekte	75
4.5 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	78

## **Kapitulli 5**

### **MBROJTJA KONSUMATORE DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN 80**

5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	80
5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë	82
5.3 Edukimi Financiar	83
5.4 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun	84

## **Kapitulli 6**

### **ORGANIZIMI INSTITUCIONAL 86**

6.1 Burime Njerëzore	86
6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	88
6.3 Auditimi i Brendshëm	90

### **STRATEGJI DHE OBJEKTIVA 91**

#### **SHTOJCA**

A. Struktura Organizative e AMF-së	94
B. Raport i Audituesit të Pavarur	95



Viti 2021 ishte një vit tjetër sfidues për ekonominë shqiptare dhe tregjet financiare. Rikthimi i valës së pandemisë vazhdoi të ushtrojë presion mbi ekonominë dhe financat. Megjithatë, ekonomia u ngrit dhe tregjet financiare u rimëkëmbën duke treguar qëndrueshmëri përballë luhatjeve të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm. Rimëkëmbja u konstatua si në nivel të ardhurash në primet e sigurimeve, ashtu dhe në aktivet e fondeve të investimeve dhe pensioneve private. Qëndrueshmëria e treguar për gjatë këtyre krizave sugjeron se sektori ka kapacitetin të përballojë presionet e sfidave të tjera, rrjedhojë e situatës së vështirë ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2021 tregu i sigurimeve u rrit me 16% krahasuar me një vit më parë, ose 9.3% krahasuar me periudhën e para krizës, vitin 2019. Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive rriti nivelin e aktiveve neto në rreth 81.9 miliardë lekë, një nivel 21.5% më i lartë se viti 2020. Fondet e pensioneve private u rritën si në aktive ashtu edhe në numër anëtarësh. Tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit mbeten të mirëkapitalizuar, me tregues të mirë likuiditeti dhe të mbulimit me provigjone.

Gjatë dy viteve të fundit është arritur një përmirësim domethënës i një pjese të konsiderueshme të bazës ligjore dhe rregullatore të tregjeve financiare. Progresi Raporti i fundit i Komisionit Evropian, vlerëson veçanërisht progresin e bërë përmes miratimit të ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm, si edhe ligjeve të tjera për tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, shoqëruar me avancimin e miratimit të kuadrit rregullator në zbatim të tyre.

Aktet e reja modernizojnë kuadrin ligjor e nënligjor për tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe e sjellin atë më afër Direktivave Evropiane. Ato vendosin gjithashtu standarde evropiane për organizimin dhe veprimtarinë e subjekteve që ofrojnë shërbime në investime, si edhe ndaj institucioneve të tregut të kapitaleve. Në kuadër të plotësisht të përshtatshmërisë, këto subjekte iu nënshtruan një procesi të plotë të rishikimit dhe përditësimit të rregullave dhe procedurave të tyre operacionale.

Harmonizimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian ka shtuar mundësitë dhe ka diversifikuar hapësirat, duke sjellë një vëmendje të shtuar të emrave të rëndësishëm evropianë për të qenë të pranishëm në vendin tonë, përmes platformave të ndërlidhjes me tregjet ndërkombëtare, ose fondeve të investimit. Zgjerimi i pranisë ndërkombëtare në tregjet financiare rrit standardet e tregut, rrjedhimisht edhe ato të mbikëqyrjes.

Viti 2021 shënoi arritje të rëndësishme sa i përket digjitalizimit dhe përmirësimit të sistemeve të raportimit, të cilat kanë çuar në përmirësimin e aksesit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e efektivitetit në proceset mbikëqyrëse. U realizua integrimi i plotë i shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve në portalin e-Albania, duke u mundësuar



**Ervin Mete**  
Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv  
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare


---


qytetarëve përfitimin në kohë reale të dokumenteve në lidhje me vlefshmërinë e policave të sigurimit ose historikun e dëmeve të mjetit. Gjithashtu u realizua përmirësimi i sistemit të raportimit për tregun e sigurimeve me versionin më të ri, duke shtuar funksionet dhe raportet analitike në kuadër të proceseve mbikëqyrëse.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti do të përfundojë pjesën e mbetur të kuadrit rregullator dhe procesit të përshtatshmërisë së subjekteve me ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe fondeve. Gjithashtu do të avancojë me nismat e tjera ligjore, si ligji i ri për fondet e pensioneve private, me synim përafrimin me direktivat evropiane dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Autoriteti synon të realizojë një vlerësim të plotë të nivelit të përputhshmërisë me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime, me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare. Modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe avancimi drejt mbikëqyrjes së plotë me fokus rrezikun mbeten disa nga prioritetet e Autoritetit.

Ervin METE

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Handwritten signature of Ervin Mete in black ink, written in a cursive style.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve, tregut të letrave me vlerë, tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Në ushtrimin e veprimtarisë rregullative dhe mbikëqyrëse, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

## BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2021, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar:	Z. Olsi Çoku <sup>1</sup> ,	Kryetar Bordi
Anëtarë:	Z. Ervin Mete,	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
	Znj. Mimoza Kaçi,	Nëndrejtor Ekzekutiv
	Z. Idir Gjata,	Anëtar Joekzekutiv
	Z. Deniz Deralla,	Anëtar Joekzekutiv

Funksionet dhe kompetencat e Bordit të AMF-së janë parashikuar në Ligjin nr. 9572, datë 03.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar. Në zbatim të tij, Bordi miraton politikat e strategjitë e zhvillimit të Autoritetit dhe të tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe aktet nënligjore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre tregjeve, institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare jobankare që mbikëqyren nga Autoriteti.

Gjatë vitit 2021, Bordi ka zhvilluar 13 mbledhje dhe ka marrë 259 vendime. Vendimet që lidhen me tregun e sigurimeve zënë numrin më të madh të vendimeve të miratuara. Bordi i ka kushtuar vëmendje edhe zhvillimit të tregjeve të tjera si ai i sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregut të titujve, për të cilat janë marrë vendime të rëndësishme të cilat janë të lidhura edhe me miratimin e ligjeve të reja në këto tregje.

Duke e cilësuar plotësimin e kuadrit rregullator për tregjet nën mbikëqyrje si një ndër prioritetet e punës së tij, Bordi i Autoritetit ka miratuar 16 rregullore të reja, 2 udhëzime, si dhe ka ndryshuar 5 rregullore ekzistuese.

**Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së gjatë vitit 2021 sipas llojit të vendimit**

Llojet e vendimeve	Numër
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	137
Vendime për Bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	18
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	36
Vendime për bashkëpunimin institucional	1
Vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	28
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së dhe tregjeve të mbikëqyrura	39
<b>Vendime në tërësi</b>	<b>259</b>

<sup>1</sup> Z. Olsi Çoku është emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në detyrën si Kryetar i Bordit të AMF-së në datë 08.03.2021





Tregjet financiare jobankare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, gjatë vitit 2021 ishin të qëndrueshme dhe me ecuri pozitive, duke i rezistuar efekteve vazhduese të pandemisë. Autoriteti gjatë vitit 2021 ka monitoruar me kujdes zhvillimet në këto tregje dhe ka vlerësuar në vijimësi ndikimin e situatës pandemike tek treguesit financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje.

Gjatë vitit 2021, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit arriti në rreth 127 miliardë lekë, duke u rritur me 15.7% krahasuar me vitin 2020. Totali i aseteve në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) rezultoi të jetë 6.7%. Nga pikëpamja e aseteve, tregu më i madh për t'u mbikëqyruar vijon të jetë tregu i fondeve të investimeve, i cili përbën rreth 4.3% të PBB-së.

Gjatë vitit 2021 **shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive** me ofertë publike, fondet e investimeve dhe depozitarët e tyre u përfshinë në procesin e përshtatjes së veprimtarisë së tyre me kërkesat e kuadrit rregullator të përcaktuar nga Ligji nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij. Autoriteti mori në shqyrtim mjaft elementë, standardet e qeverisjes së brendshme, procedurat administrative dhe kontabël për vlerësimin real të rrezikut, sistemet që mbulojnë aktivitetin e shoqërisë administruese dhe masat mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, si edhe pëmbushjen e të gjitha kërkesave për përshtatshmërinë dhe aftësinë e personave dhe personelit kyç. Deri në fund të vitit 2021, të gjitha shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe bankat depozitare kanë paraqitur në Autoritet raportin e detajuar të përshtatshmërisë me kërkesat e ligjit të ri dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK), vlera neto e aseteve për periudhën 31.12.2021, arriti në rreth 81.9 miliardë lekë, me një rritje me 21.5% krahasuar me vitin 2020. Gjatë këtij viti, për të kryer aktivitetet në këtë treg, janë licencuar nga Autoriteti dy fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dhe janë regjistruar dy fonde investimesh alternative. Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është 40,055, duke shënuar një rritje me 22.66%.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Autoriteti ka vijuar punën për hartimin dhe miratimin e rregulloreve në zbatim të këtij ligji. Gjatë vitit 2021, në zbatim të ligjit të ri janë miratuar 5 rregullore të cilat plotësojnë tërësisht kuadrin rregullator për këtë treg.

Viti 2021 shënoi zhvillime të rëndësishme përsa i përket aktivitetit ligjor e rregullator edhe në **tregun e sigurimeve**. Më 16.03.2021 u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili hyri në fuqi më datë 1 korrik 2021.


Miratimi i Ligjit nr. 32/2021 është vlerësuar në veçanti nga Komisioni Evropian në Progres Raportin për Shqipërinë, i cili ndër të tjera nënvizon progresin në lidhje me rekomandimet e lëna, përmes miratimit të ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Autoriteti ka vijuar të mbikëqyrë dhe të analizojë treguesit e shoqërive që operojnë në tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin e tyre financiar, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel tregu. Shoqëritë e sigurimit shfaqën qëndrueshmëri dhe situata financiare e tyre u paraqit me një nivel të përshtatshëm likuiditeti, duke ruajtur treguesit në nivel tregu. Performanca e tregut të sigurimeve ishte pozitive dhe u shoqërua me rritje të investimeve financiare me rreth 1.3 miliardë lekë, krahasuar me një vit më parë. Niveli i primeve të shkruara bruto në këtë treg, në fund të vitit 2021 u rrit me 16%, krahasuar me vitin 2020, duke arritur në rreth 19.3 miliardë lekë. Në sigurimin Jo-Jetë, i cili vijoi të dominojë tregun e sigurimeve me 92.57% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto, rritja e të ardhurave konstatohet në të gjithë linjat kryesore të biznesit, përfshirë portofolin e sigurimit të detyrueshëm motorik, Karton Jeshil dhe atë të Sigurimit Kufitar. Tregu i sigurimeve vijoi të jetë i dominuar nga sigurimet e detyrueshme, që zënë 61.65% të totalit, përkundrajt 38.35% që janë sigurimet vullnetare. Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2021 ka vijuar rritjen e kapitaleve të veta me rreth 408 milionë lekë, si dhe ka një rritje me rreth 10% të nivelit të investimeve, krahasuar me fundin e vitit 2020. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës ka vijuar i qëndrueshëm në nivelin 130%. Për shoqëritë e sigurimit të Jetës mbulimi i provigjoneve matematike rezulton në nivelin 124%.

Treguesit financiarë të tregut të sigurimeve janë ndikuar pozitivisht edhe nga kapitalizimi i fitimit të vitit 2020, në zbatim të Vendimit të Bordit nr. 68, datë 28.04.2021 “Për pezullimin e shpërndarjes së dividendit”, duke dëshmuar efektivitetin e masave të marra nga Autoriteti. Këto masa ndikuan në ruajtjen e nivelit të likuiditetit në sistem dhe të treguesve financiarë, atij të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

Fondi i Kompensimit për vitin 2021, në mbyllje të vitit financiar rezulton me një tepëri prej rreth 10 milionë lekë ose me një realizim në masën rreth 104% të detyrimit të fondit për vitin 2021. Referuar të dhënave të depozituara nga BSHS, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, vlera e paguar për Fondin e Kompensimit të vitit 2021 është rreth 269 milionë lekë.

Mbështetja e zhvillimit të tregut të kapitaleve është një nga objektivat kryesore të Autoritetit. Aktualisht **tregu i kapitaleve** përbëhet nga tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare, që është edhe segmenti më i madh dhe aktiv në këtë treg dhe tregu i obligacioneve me ofertë private. Në tregun e kapitaleve gjatë vitit 2021 vepruan 13 subjekte për ofrimin e shërbimit të investimeve, nga të cilat 10 banka, që janë operatorët më aktivë në tregtimin e titujve të



Qeverisë. Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, i cili është aktiv që prej vitit 2011 ka përjetuar një dinamikë në rritje. Shuma e pashlyer e obligacioneve të emetuara me ofertë private arriti, nga rreth 8 miliardë lekë në fund të vitit 2020, në rreth 10 miliardë lekë në fund të vitit 2021, duke shënuar një rritje prej 25%.

Fokusi i Autoritetit gjatë 2021 ka qenë plotësimi i kuadrit rregullator në zbatim të Ligjit të ri për tregjet e kapitalit, me konsulencën e ekspertëve të Bankës Botërore. Edhe subjektet që operojnë në tregjet e kapitalit iu nënshtruan procesit të përshtatshmërisë, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020, “Për Tregjet e Kapitalit”. Krahas procesit të përshtatshmërisë, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga ligji i ri për tregjet e kapitalit, subjektet, kryesisht banka, kanë paraqitur aplikimin për zgjerimin e licencës me instrumente të tjera financiare, përtej titujve të Qeverisë, si dhe për ofrimin e shërbimeve të reja të investimit dhe atyre ndihmëse, që parashikohen në ligj.

**Tregu i fondeve të pensionit vullnetar**, edhe pse me peshë modeste ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, gjatë vitit 2021 shënoi një rritje të pjesëmarrjes në këto fonde me 8.2% krahasuar me vitin 2020, duke arritur në 33.571 anëtarë. Totali i asetëve neto në këtë treg arriti në 4.58 miliardë lekë, me një rritje prej 27.2% krahasuar me vitin 2020.

Autoriteti ka hartuar draftin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/2341 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14.12.2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP).

Vëmendje e posaçme i është kushtuar proceseve të digjitalizimit, si edhe përmirësimit në vazhdimësi të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Kështu, në vitin 2021, AMF finalizoi integrimin e plotë të shërbimeve që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik, duke lehtësuar procedurat për qytetarët për t’u pajisur me informacionet apo vërtetimet e nevojshme në kohë reale përmes e-Albania. Autoriteti realizoi gjatë vitit 2021 një përditësim të sistemit të raportimit në tregun e sigurimeve, AMF In-Reg, që mundëson rritjen e parametrave të sigurisë, përditësim të sistemit, si edhe ofrimin e funksioneve të reja.

Autoriteti i ka kushtuar vëmendje zhvillimit profesional të punonjësve, duke mundësuar trajnime të ndryshme, edhe në kuadër të projekteve të asistencës, si edhe përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, si dhe me shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve.

## Kapitulli 1

### Ecuria e Tregjeve nën Mbikëqyrje

Gjatë vitit 2021, totali i aseteve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit arriti në rreth 127 miliardë lekë, duke u rritur me 15.7% krahasuar me vitin 2020. Totali i aseteve në raport me PBB-në<sup>2</sup> rezultoi të jetë 6.7%. Nga pikëpamja e aseteve, tregu më i madh për t'u mbikëqyruar vijon të jetë tregu i fondeve të investimeve, i cili përbën rreth 4.3% të PBB-së.

#### 1.1 Tregu i Kapitalit dhe Fondeve të Investimit

##### Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive

Gjatë vitit 2021, është realizuar përshtatshmëria e 5 Shoqërive Administruese të Investimeve Kolektive, 4 Depozitarëve dhe 6 Fondeve të Investimit. Procesi i përshtatshmërisë ishte kërkesë e Ligjit nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe rregulloreve në zbatim të tij. Të gjitha shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe bankat depozitare kanë depozituar në Autoritet raportin e detajuar të përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit nr.56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.


Gjatë verifikimit të procesit të përshtatshmërisë, Autoriteti ka kryer shqyrtimin e standardeve të qeverisjes së brendshme, sipas praktikave më të mira, duke përfshirë përmbylljen e detyrimeve të mëposhtme lidhur me procedurat administrative dhe kontabël për vlerësimin real të rrezikut, sistemet që mbulojnë aktivitetin e shoqërisë administruese dhe masat mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, si edhe përmbylljen e kërkesave për përshtatshmërinë dhe aftësinë e personave dhe personelit kyç.

Në përfundim të këtij procesi, Bordi i Autoritetit ka marrë vendimet përkatëse dhe ka përmbyllur brenda vitit 2021 përshtatshmërinë e shoqërive administruese të SIK me ofertë publike, fondeve të investimeve dhe depozitarët e tyre, duke i shoqëruar me formatin e ri të licencës.

Gjatë vitit 2021, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre 11 fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, dy nga të cilat janë licencuar gjatë vitit 2021. Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar janë regjistruar edhe dy fonde investimesh alternative.

Totali i aseteve neto të tregut të SIK për periudhën 31.12.2021 arriti në rreth 81.9 miliardë lekë, me një rritje me 21.5% krahasuar me vitin 2020, kryesisht për shkak të zgjerimit të aseteve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, si edhe fillimit të aktivitetit të dy fondeve alternative të investimit. Totali i aseteve neto të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në fund të vitit 2021 rezulton rreth 77.7 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 15.3%, ndërsa asetet neto të fondeve të investimeve alternative janë në vlerën 4.2 miliardë lekë. Numri i anëtarëve në tregun e fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike arriti në 40,055 në fund të vitit 2021, duke shënuar një rritje me rreth 22.7%.

2 Në ndryshim nga llogaritjet e mëparshme kur PBB-ja shprehej me çmime konstante, këtë herë është përdorur PBB nominale me çmime korrente, sipas INSTAT. Kjo mënyrë do të përdoret edhe në vijim.



Gjatë vitit 2021, asetet e SIK që operonin në treg, u administruan nga pesë shoqëri administruese, tre prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit, ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar.

Tregu i fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike dominohet kryesisht nga investimet në obligacione dhe bono thesari të Republikës së Shqipërisë, të cilat përbëjnë rreth 81.5% të aseteve të këtij tregu. Në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e rregullator, Shoqëritë Administruese kanë mbajtur likuiditete të nevojshme për fondet e investimit të cilat i investojnë në tregje joaktive. Nga mbikëqyrja e këtij tregu, gjatë vitit 2021, mbështetur në raportimin financiar të shoqërive administruese, rezultoi se treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës rregullatore për likuiditetin.

## **Tregu i kapitalit**

Autoriteti ka vijuar procesin e përshtatshmërisë së subjekteve që operojnë në tregjet e kapitalit me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” parashtrori detyrimin e subjekteve për përshtatshmërinë e veprimtarisë së tyre. Subjektet iu nënshtruan një procesi të plotë të rishikimit dhe përditësimit të rregullave dhe procedurave të tyre operacionale, rishikimit të kontratave me klientin, apo hartimit të rregullave dhe procedurave shtesë në këndvështrimin e kërkesave të reja ligjore.

Pjesë e përshtatshmërisë ishte edhe implementimi i procesit të certifikimit të personelit të dedikuar për të ofruar shërbime investimi (personelit kyç) nga vetë subjektet dhe pajisja e tyre me dokumentin për aftësi dhe përshtatshmëri. Gjatë procesit të përshtatshmërisë, Autoriteti ndërmoi një analizë të detajuar të dokumentacionit të depozituar nga subjektet dhe verifikimit të procesit të certifikimit të personelit të kryer nga vetë ato.

Në zbatim të kërkesave të reja ligjore dhe rregullative, shoqëritë hartuan një set rregullash të reja të cilat synojnë të forcojnë standardet në funksion të përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të investimeve. Në këtë drejtim, shoqëritë komisionere/bankat kanë hartuar për herë të parë dokumentin e politikave të ekzekutimit më të mirë të urdhrit të klientit, ku përcaktohet mënyra se si këto subjekte do të bëjnë përpjekjet maksimale për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm, gjatë kryerjes dhe ekzekutimit të një transaksioni me tituj në emër të klientit.

Gjithashtu, për herë të parë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloren e Autoritetit subjektet depozituan procedurën dhe metodologjinë për mënyrën e testimit dhe vlerësimit të klientit në lidhje me përshtatshmërinë e tij ndaj llojit të investimit. Autoriteti ndërmoi edhe verifikime në vend pranë disa prej subjekteve për mënyrën e funksionimit të sistemeve në ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimeve ndihmëse në përmbushje të kërkesave rregullative. Pjesë e procesit të përshtatshmërisë ishte riformatimi i licencave të subjekteve, me qëllim harmonizimin me terminologjinë, shërbimet dhe instrumentet financiare, sipas përcaktimeve të ligjit të ri për tregjet e kapitalit.

Krahas procesit të përshtatshmërisë, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga ligji i ri për tregjet e kapitalit, subjektet, kryesisht banka, kanë paraqitur aplikimin për zgjerimin e licencës me instrumente të tjera financiare, përtej titujve të Qeverisë, si dhe për ofrimin e shërbimeve të reja të investimit dhe atyre ndihmëse, që parashikohen në ligj. Në zbatim të këtij ligji dhe rregullores në fuqi, për herë të parë gjatë vitit 2021, një subjekti bankë iu dha e drejta për kryerjen e shërbimeve të investimit online, nëpërmjet një platforme tregtimi, të krijuar nga një bankë evropiane investimesh, e cila i mundëson investitorit shqiptar investime në instrumente të reja financiare, të listuara dhe tregtuara në tregjet ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2021, tregut të kapitalit iu shtua një bankë, e licencuar nga Autoriteti për ofrimin e shërbimeve të investimit si dhe shërbimit ndihmës të ruajtjes e administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve. Në tregun e kapitalit gjatë vitit 2021 ushtruan veprimtarinë e tyre subjektet e mëposhtme:

- 13 subjekte, nga të cilat 10 banka për ofrimin e shërbimeve të investimit dhe 3 shoqëri komisionere;
- 10 banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë në tituj;
- 1 bursë titujsh;
- 1 Regjistrar Titujsh dhe 1 Depozitar Qendror Titujsh, i cili krahas shërbimit të regjistrimit kryen edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes së titujve.
- 2 agjentë të lidhur të shoqërive të huaja komisionere;

**Tabelë 2: Pjesëmarrës dhe subjekte të tregut të kapitaleve, dhjetor 2021**

*(Në numër)*

Shoqëri Komisionere/Banka	Agjentë të Lidhur të Shoqërive Komisionere të Huaja	Banka që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë të Titujve
13	2	10
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private	Bursë Titujsh (Tregu i Rregulluar)	Depozitar Qendror Titujsh/Regjistrar
6	1	2



## Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë

Tregu i kapitaleve vijon të jetë i përqendruar në dy segmente kryesore: tregun e titujve të Qeverisë dhe tregun e obligacioneve me ofertë private.


Tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare mbetet segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregun e kapitaleve. Vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë në vitin 2021 arriti në rreth 37.1 miliardë lekë. Sipas të dhënave statistikore të Autoritetit për periudhën janar-dhjetor 2021, në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë ka vijuar të dominojë transaksioni “Blerje në tregun primar” me 50.6% kundrejt vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar ai mbetet ende i ulët me rreth 14.06% të totalit të transaksioneve të kryera në këtë treg.

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2021, u dominua në masën 58.13% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 41.87% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione).

Me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve të Qeverisë, nxitjen e tregut sekondar, si dhe rritjen e likuiditetit, në Shqipëri që prej vitit 2018 është zbatuar një sistem, me pjesëmarrjen e 5 bankave në rolin e Zhvilluesit të Tregut, të cilat kanë ekskluzivitetin e tregtimit të obligacioneve referencë 3-vjeçare dhe 5-vjeçare nëpërmjet sistemit të Zhvilluesve të Tregut.


**Grafik 1: Transaksione në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë, 2021**

(Në %)



**Grafik 2: Vëllimi i tregimit në tregun me pakicë sipas llojit të titujve, 2021**

(Në %)



## 1.2 Tregu i Sigurimeve

Në tregun e sigurimeve edhe gjatë vitit 2021 operuan 12 shoqëri sigurimi. Vëllimi i primeve të shkruara bruto të gjeneruara në këtë treg arriti në rreth 19.3 miliardë lekë duke pësuar një rritje me rreth 16% krahasuar me vitin 2020. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto u rritën si në aktivitetin e Jetës ashtu dhe në atë të Jo-Jetës.

Në aktivitetin e Jetës, në vitin 2021, primet e shkruara bruto u rritën me 22.74% krahasuar me vitin 2020. Rritja erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së kontratave në sigurimin e Jetës së debitorit, me afro 82.23% e totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jetës.


Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto, në vitin 2021 u rritën me 15.5% krahasuar me vitin 2020. Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, me rreth 53.8% e totalit të rritjes së primeve në sigurimin e Jo-Jetës.






**Grafik 3: Primi i shkruar bruto**

(Në mld. lekë)



**Grafik 4: Ndarja e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit, viti 2021**

(Në %)




Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik, i cili përfaqëson rreth 60% të totalit të dëmeve në tregun e sigurimeve, u rritën me rreth 20.2% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, duke arritur në 4 miliardë lekë. Në nivel tregu, totali i dëmeve të paguara bruto për vitin 2021 arriti në 6.7 miliardë lekë, me rënie prej 11%, kryesisht për shkak të pagesës së pjesës më të madhe të dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e fundvitit 2019, përgjatë vitit 2020. Në vitin 2021, në sigurimin e Jo-Jetës u paguan 6.1 miliardë lekë, ndërsa në sigurimet e Jetës u paguan rreth 339 milionë lekë dëme.

Pjesa tjetër prej rreth 269 milionë lekë të dëmeve të paguara i përkasin Fondit të Kompensimit, i cili në vitin 2021, për herë të parë në pesë vitet e fundit shënoi një realizim pagesash prej rreth 104%, duke rezultuar me një tepriçë prej rreth 10 milionë lekësh.

**Grafik 5: Ecuria e dëmeve të paguara bruto në vite**

(Në mld. lekë)



### 1.3 Tregu i Fondeve të Pensionit Vullnetar

Tregu i Fondeve të Pensionit Vullnetar shënoi rritje për vitin 2021 si në vlerë asetesh neto, ashtu edhe për numrin e anëtarëve. Vlera e asetëve neto të fondeve të pensionit vullnetar në fund të vitit 2021 arriti në 4.58 miliardë lekë, me një rritje prej 27.23% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa numri i anëtarëve të fondeve arriti në 33,571 në fund të vitit 2021, me një rritje prej 8.22%.

Gjatë vitit 2021, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni vullnetar të administruara nga katër shoqëri administruese, tre prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar.

Investimet e tregut të pensioneve në 31.12.2021 arritën në 4.21 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me 21.56% krahasuar me vitin 2020. Këto investime konsistojnë kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë me 91.49% ndaj totalit të asetëve. Megjithë ecurinë pozitive, tregu i pensioneve private vullnetare ka potencial për zhvillimin e mëtejshëm të tij.



### 2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitalit dhe Fondeve të Investimit

#### Tregu i Fondeve të Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike


##### 2.1.1 Pozicioni financiar

Gjatë vitit 2021, në tregun e SIK ushtruan aktivitetin e tyre njëmbëdhjetë fonde investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, dy nga të cilat janë licencuar gjatë vitit 2021. Këto fonde investimesh janë administruar nga pesë shoqëri administruese, tre nga të cilat kryejnë veprimtarinë e administrimit si për SIK, ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera kryejnë veprimtarinë e administrimit vetëm për SIK.

Që nga fillimi i veprimtarisë së fondit të parë të investimit, në vitin 2012, tregu i fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe ky treg tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Asetet neto të tregut të fondeve të investimeve me ofertë publike arritën në 77.7 miliardë lekë në 31.12.2021. Krahasuar me vitin 2020 asetet neto të këtij tregu, pësuan një rritje me 10.2 miliardë lekë ose 15.26%. Në 31.12.2021 numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 40,055 nga të cilët 99.91% janë investitorë individualë.

**Grafik 6: Asetet neto të tregut të fondeve të investimit në vite**

(Në mln. lekë)



Investimet e tregut të fondeve të investimit konsistojnë në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., bono thesari të Qeverisë së R.SH., obligacione të shoqërive jashtë vendit, kuota në fonde investimi si dhe aksione në shoqëri të huaja.

**Tabelë 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, sipas periudhave tremujore, 2021** (Në mln. lekë)

Përshkrimi	Vlera			
	31.03.2021	30.06.2021	30.09.2021	31.12.2021
<b>Periudha</b>				
Asetet neto të fondeve	69,617	71,852	75,145	77,691
<b>Totali i asetëve të fondeve</b>	<b>69,051</b>	<b>72,520</b>	<b>75,522</b>	<b>77,862</b>
nga të cilët:	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	44,030	46,570	48,843	50,027
Obligacione të Shoqërive	2,513	2,500	2,425	2,355
Bono Thesari	11,472	11,569	11,359	13,626
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,096	2,285	2,547	2,558
Aksione në shoqëri të huaja	202	225	231	297
Mjete Monetare	8,684	8,610	9,468	8,221
Asete të tjera	619	762	649	779
<b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>	<b>566</b>	<b>688</b>	<b>377</b>	<b>172</b>


Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike të vitit 2021 kundrejt vitit 2020 si dhe pesha që zë secili nga përbërësit e portofolit në totalin e aktiveve në vitin 2020 dhe 2021.

**Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, 31.12.2020 - 31.12.2021**


Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'20	31.12.'21		31.12.'20 31.12.'21	31.12.'20 31.12.'21
<b>Periudha</b>					
Asetet neto të fondit		77,691	15.26		
<b>Totali i asetëve të fondeve</b>		<b>77,862</b>	<b>15.27</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
nga të cilët:	-	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	46,256	50,027	8.15	68.48	64.25
Obligacione të Shoqërive	2,339	2,355	0.68	3.46	3.02
Bono Thesari	9,923	13,626	37.32	14.69	17.50
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,063	2,558	23.99	3.06	3.29
Aksione në shoqëri të huaja	151	297	96.69	0.22	0.38
Mjete Monetare	6,102	8,221	34.73	9.04	10.56
Asete të tjera	711	779	9.56	1.05	1.00
<b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>		<b>172</b>	<b>21.13</b>	<b>0.21</b>	<b>0.22</b>



**Grafik 7: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2020** (Në %)




**Grafik 8: Struktura e asetëve të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2021** (Në %)



Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit, shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat investojnë në tregje joaktive, të mbajnë likuiditetin në përputhje me kërkesat rregullatore në fuqi. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm për 31.12.2021, investimet e tregut të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike me maturim deri në një muaj janë 15.38%.

**Grafik 9: Profili i investimeve të tregut të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike 31.12.2021** (Në %)



### Tregu i kapitalit

Autoriteti monitoron në vijimësi veprimtarinë e subjekteve të licencuara në tregun me pakicë të Titujve të Qeverisë. Ky treg është organizuar në formën e Tregut Mbi Banak dhe përfshin vetëm tregtimet ndërmjet shoqërive komisionere të licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të letrave me vlerë (kryesisht banka) dhe investitorëve individualë apo investitorëve-persona juridikë. Në kuadër të mbikëqyrjes, Autoriteti edhe gjatë vitit 2021 ishte në komunikim të vazhdueshëm me subjektet e këtij tregu, me synim rakordimin e të dhënave të raportuara prej subjekteve dhe të dhënave të sistemit GSRM për këtë treg.

### Tregu i rregulluar – Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE

Që prej fillimit të aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE, në shkurt të vitit 2018, deri në dhjetor të vitit 2021 në Bursën Shqiptare të Titujve është realizuar një vëllim tregtimi prej 3.3 miliardë lekë, prej të cilave rreth 1.47 miliardë lekë i përkasin volumit të tregtimit të realizuar gjatë vitit 2019, 452 milionë lekë, i përkasin volumit të tregtimit të realizuar përgjatë vitit 2020, ndërsa rreth 3 milionë lekë është volumi i tregtimit për vitin 2021. Titujt e Qeverisë Shqiptare janë të vetmit tituj që janë tregtuar në Bursë.

**Tabelë 5: Ecuria në vite e vëllimit të tregtimit në bursë** (Në mln. lekë)

	2018	2019	2020	2021
Vëllimi i tregtimit në bursë	1,380	1,474	452	3.03



Bursa Shqiptare e Titujve numëron aktualisht 3 anëtarë (banka), të cilët kryejnë transaksione për llogari të portofolit të tyre dhe për llogari të klientëve. Në totalin e transaksioneve të kryera gjatë vitit 2021 dominuan me 100% transaksionet në obligacione thesari, të kryera në monedhën lekë dhe për llogari të klientëve individë.

**Tabela 6: Raporti i transaksioneve të kryera në bursë midis bankave për llogari të portofolit të tyre ndaj transaksioneve të kryera për llogari të klientëve, 2021**

(Në % ndaj totalit)

Lloji i transaksionit	Nr. i transaksioneve	Vlera e Tregtimit
Ndërbankare	33.33	17.44
për Klientët	66.67	82.56
Individë	66.67	82.56
Pers. Juridik	-	-

### Infrastruktura e pastregtimit

Infrastruktura e pastregtimit është bërë plotësisht funksionale në muajin mars 2021, me pranimin e shoqërisë "Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG", si pjesëmarrës indirekt në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, i cili është sistem i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe. Ky anëtarësim i ALREG si pjesëmarrës në këtë sistem, mundëson procesin që lidhet me finalizimin e shlyerjes së transaksionit me tituj. Shoqëria ALREG, që prej licencimit të saj në vitin 2019, ka regjistruar 10 emetime të obligacioneve me ofertë private, me një vlerë prej rreth 5.8 miliardë lekë. Gjatë 2021, ALREG ka regjistruar 4 emetime në shumën rreth 3.05 miliardë lekë, nga ku rreth 55.13% e kësaj shume të regjistruar është në monedhën EUR, 2.36% në monedhën USD dhe 42.51% në lekë.

### Tregu i obligacioneve me ofertë private

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, i cili është aktiv që prej vitit 2011, ka përjetuar dinamikë në rritje. Shuma e pashlyer e këtij lloj instrumenti financiar arriti nga rreth 8 miliardë lekë në fund të vitit 2020, në rreth 10 miliardë lekë në fund të vitit 2021, me një rritje prej rreth 25%. Aktualisht në treg janë 6 emetues të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 4 banka, 1 institucion mikrokredie dhe 1 shoqëri tregtare. Përgjatë vitit 2021, Autoriteti ka regjistruar 5 akt-oferta të përgatitura nga 3 emetues (banka). Investitorët e këtyre obligacioneve janë kryesisht individë (mbi 95%) dhe disa persona juridikë.

## 2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

### 2.2.1 Pozicioni financiar

Autoriteti, gjatë vitit 2021, ka mbikëqyrur dhe ndjekur në vazhdimësi dinamikën e tregut të sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive në nivel individual dhe në tërësi të gjithë tregut të sigurimeve. Autoriteti ka vijuar ndjekjen e përmbushjes së kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

**Tabelë 7: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivet\***

(Në mln. lekë)

	31.12' 17	31.12' 18	31.12' 19	31.12' 20	31.12' 21
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>30,579</b>	<b>31,564</b>	<b>38,803</b>	<b>38,865</b>	<b>40,571</b>
Jeta	3,382	3,327	4,105	4,814	5,075
Jo-Jeta	27,197	28,237	34,699	34,051	35,496
<b>Totali i investimeve</b>	<b>19,425</b>	<b>20,648</b>	<b>22,151</b>	<b>25,029</b>	<b>27,585</b>
Jeta	2,851	2,822	3,578	4,258	4,401
Jo-Jeta	16,574	17,826	18,574	20,770	23,184
<i>*Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a te Albsig Jetë sh.a.</i>					

Në 31.12.2021 totali i aktiveve të tregut të sigurimeve është rreth 41 miliardë lekë, duke u rritur me 1.7 miliardë lekë, ose 4.4%, krahasuar me fundvitin 2020. Nga këto aktive 88% të totalit i përkasin shoqërive të tregut të Jo-Jetës dhe 12% shoqërive të tregut të Jetës.


Rritja e totalit të aktiveve është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorit të Jo-Jetës, me rreth 1.4 miliardë lekë ose rreth 4% më shumë, krahasuar me 31.12.2020. Edhe sektori i Jetës ka pësuar rritje të totalit të aktiveve me rreth 261 milion lekë ose 5.4%. Kjo rritje ka ardhur edhe si rezultat i kapitalizimit nga ana e shoqërive të fitimeve të vitit 2020 në zbatim të Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 68, datë 28.04.2021, i cili u mor në kushtet e vazhimit të pandemisë Covid-19, si dhe rezultatit financiar pozitiv të realizuar nga tregu i sigurimeve për vitin 2020.





**Grafik 10: Totali i aktiveve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite**

(Në mln. lekë)




Për sektorin e Jo-Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht nga rritja e zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare”, ku “toka dhe ndërtesa” janë rritur me rreth 1.1 miliardë lekë ose 24.8% më shumë krahasuar me 31.12.2020. Gjithashtu dhe investimet financiare paraqiten me rritje të konsiderueshme prej 1.3 miliardë lekë ose 8%. Edhe këtë vit financiar ka pasur rënie të zërit “Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike” me rreth 1 miliardë lekë ose 19% më pak krahasuar me 31.12.2020, si pasojë e përfundimit të pjesës kryesore të pagesave për dëmet e shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019 si dhe uljes së pjesës së risiguruesve në dëmet e ndodhura gjatë vitit financiar 2020.

Për sektorin e Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht nga rritja e zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 142 milionë lekë ose 3.3% më shumë krahasuar me 31.12.2020.

Edhe në 31.12.2021, investimet kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve të tregut të sigurimeve me vlerë 27.5 miliardë lekë, duke zënë rreth 68% të totalit të aktiveve. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është rreth 2.5 miliardë lekë ose 10% më shumë.

**Grafik 11: Totali i investimeve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite**

(Në mln. lekë)




Struktura e aktiveve për të dy sektorët e tregut të sigurimeve, krahasuar me 31.12.2020 ka shfaqur zhvillimet kryesore të mëposhtme:

Depozitat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të aktiveve me 30%, ndjekur nga zëri “Toka dhe ndërtesa” dhe “Bono thesari dhe obligacione”, të cilët kanë pësuar rritje me nga rreth 2% në strukturën e aktiveve për tregun e sigurimeve. Rënie me 3% krahasuar me vitin 2020 ka patur zëri “Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike”, si rezultat i pagesave nga shoqëritë për dëmet e shkaktuara nga tërmetet e ndodhura në vitin 2019.

**Grafik 12: Struktura e Aktivit për tregun e sigurimeve**

(Në %)





**Tabelë 8: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi\***

(Në mln. lekë)

	31.12.'17	31.12.'18	31.12'19	31.12'20	31.12'21
<b>Totali i Pasivit</b>	<b>30,579</b>	<b>31,564</b>	<b>38,803</b>	<b>38,865</b>	<b>40,571</b>
Jeta	3,382	3,327	4,105	4,814	5,075
Jo-Jeta	27,197	28,237	34,699	34,051	35,496
<b>Provigjonet teknike bruto</b>	<b>15,840</b>	<b>16,393</b>	<b>22,100</b>	<b>20,986</b>	<b>22,019</b>
Jeta	1,702	1,728	1,902	2,031	2,236
Jo-Jeta	14,138	14,665	20,199	18,956	19,783
<b>Totali i kapitaleve të veta</b>	<b>9,418</b>	<b>10,665</b>	<b>11,145</b>	<b>12,651</b>	<b>13,059</b>
Jeta	1,542	1,509	2,019	2,419	2,454
Jo-Jeta	7,876	9,156	9,126	10,232	10,605
<b>Totali i kapitalit të nënshkruar</b>	<b>6,953</b>	<b>7,366</b>	<b>7,366</b>	<b>7,473</b>	<b>7,743</b>
Jeta	1,221	1,230	1,632	1,882	1,882
Jo-Jeta	5,732	6,136	5,734	5,591	5,861

*\*Në pasivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a. te Albsig Jetë sh.a.*


Në vitin 2021, provigjonet teknike në total për tregun e sigurimeve kanë pësuar një rritje me rreth 1 miliard lekë ose 5% më shumë se në vitin 2020.

Gjithashtu edhe kapitalet e veta të shoqërive janë rritur me rreth 408 milionë lekë ose rreth 3% më shumë se një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur edhe si rezultat i kapitalizimit nga ana e shoqërive të fitimeve të vitit 2020 në zbatim të Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 68, datë 28.04.2021, i cili u mor në kushtet e vazhdimit të pandemisë Covid-19.

Përsa i përket strukturës së pasiveve të tregut të sigurimeve, ajo dominohet nga zërat e provigjoneve teknike, ku përfshihen provigjonet për primin e pafituar për pjesën që i përket periudhës së mbulimit pas mbylljes së vitit financiar dhe provigjonet e dëmeve, si dhe “kapitalet e veta”, të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e entitetit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të tij. Në 31.12.2021 provigjonet teknike zënë 54% të totalit të pasiveve ndërsa “kapitalet e veta” zënë 32%.


**Grafik 13: Struktura e Pasivit për tregun e sigurimeve**

(Në %)



Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2021 për tregun e sigurimeve në total, janë në vlerën rreth 28.5 miliardë lekë, përkatësisht për tregun e sigurimit të Jo-Jetës këto aktive janë në vlerën 25.7 miliardë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës janë në vlerën rreth 2.8 miliardë lekë. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës për vitin 2021 është 130%, kundrejt 132% që ishte për vitin 2020. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike në 31.12.2021 rezulton në nivelin 124% nga 129.6%, që ishte në 31.12.2020.

**Grafik 14: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike** (Në %)






## Rezultati financiar

Gjatë vitit 2021, tregu i sigurimeve ka patur një ecuri pozitive të të ardhurave nga primet, të cilat në total neto janë rritur me 11%, krahasuar me një vit më parë. Rezultati financiar në fund të vitit 2021 për shoqëritë e sigurimit ka pësuar një rënie me 438 milionë lekë, krahasuar me vitin 2020. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rënies me rreth 411 milionë lekë të tregut të Jo-Jetës, ndërkohë që tregu i Jetës ka rezultuar me rënie të rezultatit financiar në vlerën 27 milionë lekë.

Rënia e rezultatit financiar të tregut të Jo-Jetës për vitin 2021 është e ndikuar kryesisht nga aplikimi i politikave kontabël lidhur me zhvlerësimet e aseteve dhe provigjonimet e debitorëve nga aktiviteti i sigurimit. Kjo pasqyrohet në grafikun 15. Sa i përket tregut të Jetës, rënia me 27 milionë lekë është ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve operative përkundrejt primeve të shkruara bruto, si edhe rritja e pagesës së dëmeve si pasojë e COVID-19.


**Grafik 15: Rezultati financiar për tregun e sigurimit të Jo-Jetës dhe Jetës** (Në mln. lekë)



**Raporti dëme/prime:** Dëmet e paguara pa përfshirë pagesën e dëmeve nga risiguruesit (dëmet neto) në raport me primet e fituara neto në 31.12.2021, për tregun e Jo-Jetës rezultuan në nivelin 34.9% nga 31.9% një vit më parë. Për tregun e Jetës raporti dëme/prime neto për 31.12.2021 është 24.1%, nga 26.6% në 31.12.2020.

**Grafik 16: Raporti dëme/prime për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës**


(Në %)




**Raporti i shpenzimeve** përfaqëson raportin midis shpenzimeve operative neto dhe shpenzimeve të tjera neto për sigurimet kundrejt primeve të fituara neto, për tregun e Jo-Jetës për 31.12.2021 rezulton rreth 60.9%, nga 60.6% në 31.12.2020. Për tregun e Jetës raporti i shpenzimeve për 31.12.2021 është 66.8%, nga 60.7% që ka qenë një vit më parë duke rezultuar me një rritje prej rreth 6%.

**Grafik 17: Raporti i shpenzimeve për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës**

(Në %)





## Mbikëqyrja në distancë

Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, AMF ka ushtruar mbikëqyrje në distancë nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raportimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe institucione të tjera. Mbikëqyrja në distancë fokusohet tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur nga raportimet periodike apo ad-hoc të shoqërive të sigurimit, me theks të veçantë tek analizat financiare dhe aktuariale. Konkretisht, në fokus të mbikëqyrjes në distancë për periudhën raportuese ishin:

- Përgatitja e raporteve të analizave financiare në distancë për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë për periudhat tremujore raportuese, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit si dhe informacioneve nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimi i raporteve të audituesve të jashtëm për shoqëritë e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit paraardhës;
- Monitorimi i ecurisë të normës së likuiditetit për shoqëritë e sigurimit;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituesve të brendshëm të shoqërive të sigurimit;
- Shqyrtimi i planeve vjetore të biznesit të shoqërive;
- Monitorimi i publikimit të raportit vjetor të shoqërive si dhe publikimi i informacionit lidhur me ndikimin e pandemisë shkaktuar nga Covid-19;
- Analizimi i raporteve të vetëvlerësimit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Llogaritja me bazë tremujore e provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e kufirit minimal të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit;
- Analizimi i marrëveshjeve të risigurimit, si dhe vlerësimi i cilësisë së risiguresit;
- Monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10% të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

### **2.2.2 Inspektimet**

Autoriteti ka vijuar kryerjen e inspektimeve në vend edhe gjatë vitit 2021, ndonëse më të kufizuara në numër, për shkak të vijimit të pandemisë COVID-19.

#### **Inspektime të plota me fokus rrezikun**

Gjatë vitit 2021, AMF realizoi një inspektim të plotë të planifikuar tek një nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun. Inspektimet me bazë rreziku përqendrohen në vlerësimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet edhe në përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar të saj.

Këto inspektime synojnë vlerësimin e rrezikut të kreditit, të sigurimit, operacional, ligjor/ rregullator dhe strategjik si dhe në vlerësimin e cilësisë së kapitalit, fitimeve dhe elementeve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë. Gjithashtu në fokus të këtyre inspektimeve është dhe vlerësimi i menaxhimit të rrezikut, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë nga nivelet drejtuese të shoqërisë.


Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti vlerëson rrezikun për çdo aktivitet të shoqërive të sigurimit të inspektuara dhe përditësoi profilin e rrezikut të tyre. Profili i rrezikut shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut.

#### **Inspektime tematike**

Gjatë vitit 2021, janë kryer 5 inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Objekti i këtyre inspektimeve tematike ishte shqyrtimi i procesit të marrjes në sigurim për kontratat e lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit, në zbatim të elementëve dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti, konkretisht:

- Verifikimi i përputhshmërisë së elementëve dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të lëshuara gjatë periudhës objekt inspektimi, me bazën ligjore në fuqi;
- Procedurat e brendshme të marrjes në sigurim dhe përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëria;
- Mbulimi me risigurim për kontratat e sigurimit të lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit.





Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti u komunikoi shoqërive gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si dhe adresoi me Vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarrë nga shoqëritë e sigurimeve. Zbatueshmëria e këtyre rekomandimeve është në vëmendje të Autoritetit si për respektimin e afateve dhe detyrave të lëna.

### **Inspektime të përbashkëta**

Në kuadër të bashkëpunimit vijues me Bankën e Shqipërisë, AMF gjatë vitit 2021 ka kryer 2 inspektime të përbashkëta pranë bankave tregtare. Këto inspektime synojnë verifikimin e aktivitetit të shoqërive të sigurimit nëpërmjet sistemit bankar. Objekt i këtyre inspektimeve ishte verifikimi i kontratave që shoqëritë e sigurimit lëshojnë për palë të treta, verifikimi i vlerave monetare të shoqërive të sigurimit, llogaritë bankare dhe depozitat qëllimore dhe me afat, si dhe verifikimi i aseteve të shoqërive të sigurimit pranë këtyre bankave. Gjithashtu, në këto inspektime Autoriteti u fokusua dhe në verifikimin e marrëveshjeve të shoqërive të sigurimit me bankat, me qëllim mbrojtjen e konsumatore në drejtim të transparencës në procesin e marrjes në sigurim. Në përfundim të këtyre inspektimeve qështjet e konstatuara janë adresuar nëpërmjet Bankës së Shqipërisë bankave tregtare të inspektuara, si dhe shoqërive të sigurimit.

#### **2.2.3 Mbikëqyrja e grupeve**

Në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti kryen mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë, ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri, gjatë vitit 2021, kanë ushtruar veprimtari 4 grupe sigurimi, nga të cilat 2 grupe janë me kapital vendas dhe dy të tjerat me kapital të huaj.

Mbikëqyrja efektive e grupeve të sigurimit, bazohet në parimet themelore të sigurimeve (*International Core Principles*) dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga AMF me mbikëqyrësit e shteteve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtar që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri.

Në vitin 2021 janë kryer takime virtuale midis Autoritetit dhe kolegjeve mbikëqyrëse së grupeve të sigurimeve Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje zhvillohen në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Në këto kolegje Autoriteti raportoi mbi mbarëvajtjen e shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve Uniqa Group Austria dhe Vienna Insurance Group, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri.

### **Provigjoni Teknik**

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga siguroesi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

#### **Provigjonet teknike përfshijnë:**

- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga siguri i përgjegjësishë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmytjes dhe tërmetit.

**Provigjonet matematike** krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.



Në zbatim edhe të Strategjisë së Autoritetit 2018–2022, përfaqësues të tij dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BOK) zhvilluan edhe gjatë vitit 2021 kolegjin mbikëqyrës për një grup sigurimesh me kapital vendas që ushtron aktivitet edhe në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Qëllimi i këtyre kolegjeve është shkëmbimi i informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja. Autoriteti po shqyrton gjithashtu mundësinë e zgjerimit të këtyre kolegjeve rajonale duke përfshirë edhe grupet e tjera të sigurimit që ushtrojnë aktivitet në vendet e rajonit.

#### **2.2.4 Provigjonet Teknike**

Në vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, një tregues i rëndësishëm është edhe niveli i provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut nga shoqëritë e sigurimit.


Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Në fund të vitit 2021, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetin Jetë dhe Jo-Jetë janë rreth 22 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2020, ku vlera e provigjoneve bruto në nivel tregu rezulton rreth 21 miliardë lekë, në vitin 2021 vihet re një rritje e vlerës së provigjoneve teknike bruto në nivel tregu, me 5% ose rreth 1 miliard lekë, e ndikuar nga të dy aktivitetet. Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezulton të jetë rreth 827 milionë lekë ose 4%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezulton një rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 205 miliardë lekë ose 10%.

Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 89.86% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 19.8 miliardë lekë. Ndërsa provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në 2.22 miliardë lekë ose 10% e totalit. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës kundrejt atyre të Jetës, përkatësisht 92.57% dhe 7.43%.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjonit teknik të dëmeve dhe primeve. Në vazhdimësi, AMF ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjonit teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni për dëmet në proces gjyqësor, lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë e sigurimit.

**Grafik 18: Provigjoni teknik bruto**

(Në mld. lekë)



### **Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)**

Provigjoni teknik bruto për produktin MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2021, arrin në rreth 13.23 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me 7% krahasuar me vitin e kaluar. Pësuar rritje në 67%, nga 65% që rezultoi në fund të vitit 2020. Ndikimin kryesor e ka dhënë rënia e provigjoneve teknike bruto të dëmeve për linjën e biznesit Zjari dhe Forcat e Natyrës.

Nga të dhënat për peshën dhe strukturën e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm, vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve në krahasim me provigjontin e primit të paguar, duke ruajtur të njëjtën strukturë ndarjeje edhe gjatë vitit 2021. Për këtë portofol dëmet që kanë ndodhur dhe akoma nuk janë paguar, janë më të larta se provigjonet për dëmet që pritet të ndodhin në të ardhmen për kontratat që janë akoma në fuqi pas mbylljes së vitit financiar.



**Tabelë 9: Pesha dhe struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm**

(Në mld. lekë)

<i>Pesha e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm</i>	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Provigjone bruto total MTPL	7.61	8.26	9.76	9.82	10.73	11.80	12.37	13.23
Provigjone bruto total Jo-Jeta	9.66	12.41	13.87	14.14	14.67	20.20	18.96	19.78
Pesha specifike e sigurimeve të detyrueshme kundrejt totalit për tregun (Në %)	79	67	70	69	73	58	65	67

<i>Struktura e provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm (Në%)</i>	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Provigjoni teknik për dëmet MTPL	53	52	52	52	54	56	56	56
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL	47	48	48	48	46	44	44	44
Provigjone bruto total MTPL	100	100	100	100	100	100	100	100

### **Aplikacioni për përlogaritjen e dëmeve ndaj personit në aksidentet rrugore**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe miratimit nga Autoriteti të Rregullores nr. 125, datë 28.07.2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti ka zhvilluar aplikacionin e llogaritjes të dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit.

Ky aplikacion u vjen në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë profesionistëve/ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmit dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përlogaritësi bazohet në disa supozime, vlerat e përlogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit. Aplikacioni është ndërtuar për përlogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

Në faqen zyrtare të AMF-së gjendet aplikacioni <https://crm.amf.gov.al/deme>

Rishtë kryesore që sjell zhvillimi i këtij aplikacioni për të siguruarit dhe profesionistët e fushës janë:

- Përlogaritja automatike e vlerës së dëmit;
- Transparencë mbi vlerën e dëmit pasuror dhe dëmit jopasuror. Pasqyrimi i vlerës për çdo figurë dëmi;
- Mundësi përdorimi të aplikacionit nga ana e të dëmtuarve, si edhe profesionistëve/ekspertëve të fushës së sigurimeve, mbi bazën e disa supozimeve;
- Edukim të konsumatorëve në fushën e sigurimeve.

### 2.2.5 Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të siguruar që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të risigurimit, edhe për arsytet e mëposhtme:

- Kufizimin e ekspozimit ndaj rreziqeve të mëdha;
- Zbutjen e luhatjeve të rezultateve financiare ndër vite;
- Përmirësimin e kërkesave të kapitalit (aftësisë paguese);
- Rritjen e kapacitetit për të pranuar rreziqe; si dhe
- Asistencë teknike dhe financiare.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në AMF programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriteret e lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Marrëveshjet e risigurimit në portfolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2021 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën e rreth 2.82 miliardë lekë ose sa 14.6% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, krahasuar me fundin e vitit 2020, është rritur me rreth 165 milionë lekë ose 6.2%;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.75 miliardë lekë ose sa 15.5% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, krahasuar me fundin e vitit 2020, është rritur me rreth 153 milionë lekë ose rreth 5.9%;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 62 milionë lekë ose sa 4.3% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 11.8 milionë lekë ose 24% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2020.



Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, ka ulje të primeve të ceduara në risigurim vetëm për portofolin e sigurimeve “Aksidente dhe Shëndeti”, ndërsa për portofolet e tjera primet e ceduara janë rritur. Gjithashtu, për vitin 2021, konstatohet se peshën më të madhe ndaj primeve totale të ceduara e zënë produktet “Motorike” me 57.1% të totalit dhe “Zjarri dhe të tjera të pronës” me rreth 33.6%.


**Tabelë 10: Primet e ceduara në risigurim sipas portofoleve kryesore, 2020 dhe 2021**

(Në mln. lekë)

Lloji i Sigurimit	2021	2020
Aksidente dhe shëndet	10	88
Motorike	1,572	1,500
Zjarri e të tjera të pronës	926	816
Përgjegjësi	138	125
Të tjera	109	72
<b>Total</b>	<b>2,755</b>	<b>2,601</b>

**Grafik 19: Peshat specifike të risigurimeve sipas portofoleve kryesore për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020**

(Në %)



Krahasuar me vitin 2020, në aktivitetin e Jo-Jetës ka një rritje të primeve të ceduara në risigurim me 5.9%. Arsyet kryesore të kësaj rritje të primeve të ceduara lidhen me rritjen e primeve të shkruara bruto për vitin 2021.

Në bazë dhe për zbatim të rregullores nr. 57, datë 26.05.2017 “Mbi llogaritjen e Mbajtjes Neto të Mbulimit Maksimal Agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, referuar ekspozimit më 31.12.2021, shoqëritë e sigurimit kanë raportuar dhe normën e mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti. Bazuar në marrëveshjet e risigurimit në fuqi, tregu i sigurimeve mund të përballojë, pa cenuar treguesit financiarë, dëme deri në rreth 170 milionë Euro. Risigurimi është kryer në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 “Për kriteret e risigurimit”, e ndryshuar. Referuar agjencive klasifikuese Standard & Poors, Fitch, Moody’s, etj., cilësia e risiguruesve kryesorë të marrëveshjeve që mbulojnë aktualisht rreziqet e ceduara në risigurim nga shoqëritë e sigurimit rezulton së paku në kategorinë e vlerësimit A, që do të thotë edhe më cilësore nga sa kërkohet nga kuadri rregullator në fuqi.

### **Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)**

Në përputhje me kuadrin rregullator dhe standardet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS), shoqëritë e sigurimit kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve dhe aftësisë paguese (ORSA). Këto raporte japin një pasqyrim më të plotë të rreziqeve që ndeshin shoqëritë gjatë ushtrimit të aktivitetit, si dhe vlerësimin e kapitalit të nevojshëm për përballimin e tyre.

### **2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit**

#### **Fondi i Kompensimit për vitin 2021**

Fondi i Kompensimit për vitin 2021, në mbyllje të vitit financiar rezulton me një tepriçë prej rreth 10 milionë lekë ose me një realizim në masën rreth 104% të detyrimit të fondit për vitin 2021.


Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 201, datë 29.12.2020, ka miratuar Fondin e Kompensimit për vitin 2021 në vlerën 150 milionë lekë. Byroja Shqiptare e Sigurimit ka pasqyruar, llogaritur dhe shpërndarë Fondin e Kompensimit për vitin 2021 sipas shoqërive të sigurimit, anëtare të saj. Në detyrimin e fondit të kompensimit të vitit 2021, përveç fondit të miratuar sipas vendimit të mësipërm, është shtuar dhe balanca e fondit të kompensimit më 31.12.2020, e cila ka rezultuar në vlerën rreth 110 milionë lekë. Referuar të dhënave të depozituara nga BSHS, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, vlera e paguar për Fondin e Kompensimit të vitit 2021 është rreth 269 milionë lekë, ose rreth 104% e detyrimit të periudhës.





**Grafik 20: Ecuria e pagesave janar-dhjetor 2021**

(Në mln. lekë)



Gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021, shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS-së, përveç pagesave të detyrimeve të fondit të miratuar, kanë kryer pagesa si sigurues të drejtpërdrejtë në funksion të entit kompensues, për dëme shkaktuar nga mjete të pasiguruara/paidentifikuara, në vlerën rreth 5.77 milionë lekë. Kjo pagesë kryhet sipas kërkesave të Ligjit të ri 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Autoriteti, gjatë vitit 2021, ka kryer inspektim në vend pranë BSHS-së. Ky inspektim lidhet me veprimtarinë e Byrosë në zbatim të detyrimeve sipas Ligjit 32/2021 dhe Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove. Sipas Ligjit 32/2021, parashikohet krijimi dhe administrimi i Regjistrin Elektronik nga Byroja, i cili mbledh dhe ruan të dhënat e dëmeve objekt Fond Kompensimi.

Gjatë këtij inspektimi u verifikua dhe saktësia e regjistrimit të dhënave në Regjistrin Elektronik të Byrosë si dhe pasqyrimi dhe përditësimi i statuseve dhe vlerave të praktikave të dëmeve pezull objekt Fond Kompensimi.

## **Çështje të tjera që lidhen me Byronë Shqiptare të Sigurimit**

Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka parashikuar organizimin e Byrosë në dy departamente, Departamenti i Kartonit Jeshil dhe Departamenti i Fondit të Kompensimit. Këto departamente janë struktura të pavarura nga njëra tjetra. Nëpërmjet Departamentit të Kartonit Jeshil, Byroja, si përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove, ushtron e funksionet dhe përgjegjësitë që lindin nga anëtarësia në sistemin e Kartonit Jeshil. Ndërsa nëpërmjet Departamentit të Fondit të Kompensimit, ajo kryen funksionet e entit kompensues për pagesat e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i mjeteve të pidentifikuara/pasiguruara.

Organet drejtuese të Byrosë janë Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Ekzekutiv. Ligji 32/2021, për kriteret e përzgjedhjes së bordit të drejtorëve dhe drejtorit ekzekutiv referon në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” i cili përcakton kërkesat ligjore dhe nënligjore të kualifikimit, përvojës dhe përshtatshmërisë së anëtarit të drejtorisë së një shoqërie sigurimi. Gjithashtu, kërkesë tjetër sipas Ligjit të ri 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” për miratimin e anëtarëve të Bordit është dhe kriteri që ata nuk mund të jenë palë të lidhura me shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë që auditojnë pasqyrat financiare të Byrosë. Afati i mandatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorit Ekzekutiv të BSHS-së është 4 vjet, me të drejtë riemërimi.

Në mbrojtje të interesave të konsumatorit për fleksibilitet më të lartë, ligji aktual ka parashikuar që përveç Byrosë Shqiptare të Sigurimit që kryen funksionet e entit kompensues, edhe shoqëritë e sigurimit kanë të drejtën të kryejnë funksionet e entit kompensues si sigures i drejtpërdrejtë, për trajtimin, kompensimin dhe rimbursimin e dëmeve, të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara/pidentifikuara.

## **Zbatimi i kushteve të monitorimit të vendosura nga Këshilli i Byrove për BSHS-në ka qenë në vëmendje dhe gjatë vitit 2021.**

Në vijim të zbatimit të kërkesave të vendosura nga Këshilli i Byrove, disa nga rekomandimet e këtij Këshilli kanë patur fokus si më poshtë:

- Të provuarit e fondeve/garancive që BSHS duhet të posedojë në cilësinë e Byrosë Garantuese (për dëme të ndodhura jashtë Shqipërisë), dhe cilësinë e Byrosë Trajtuese (për dëme të ndodhura në Shqipëri);
- Të provuarit e mosekzistencës së rasteve të thirrjeve të garancisë (pra kur anëtarët tanë, nuk paguajnë në afat dëmet e ndodhura jashtë Shqipërisë).
- Sigurinë juridike në kuadrin e transparencës së kriterëve që duhet të plotësojë një subjekt për të funksionuar si korrespondent dëmsh karton jeshil në Shqipëri;



- Pasjen e një fryme të mirë bashkëpunimi ndërmjet BSHS dhe byrove homologe, duke patur fokus sidomos në rastet e aksidenteve në Shqipëri, me të dëmtuar shtetas të huaj.

Lidhur me disa nga kërkesat kryesore, Ligji 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ka parashikuar krijimin e garancive/fondeve për trajtimin dhe garantimin e pagesave të dëmeve të kartonit jeshil, organizimin e Byrosë dhe decentralizimin e funksioneve të saj, kriteret e përshtatshmërisë për përzgjedhjen e bordit të drejtorëve, si dhe kufizime për konfliktin e interesit apo palë të lidhura.

Gjatë këtij viti në sistemin online të Këshillit të Byrove janë raportuar 3 “Thirrje Garancie”, të cilat janë shlyer menjëherë nga shoqëritë e sigurimit. Krijimi i garancisë së Kartonit Jeshil nga çdo anëtar, në vlerën jo më të vogël se 250,000 euro, në favor të Byrosë, i njeh të drejtën Byrosë të kryejë pagesat e dëmeve sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Byrove, duke minimizuar thirrjet e garancive në sistem.

## 2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar

### 2.3.1 Pozicioni financiar

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij ka patur tendencë në rritje, si përsa i përket aseteve që menaxhon, ashtu edhe numrit të kontribuesve.

Totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2021 është rreth 4.6 miliardë lekë me një numër prej 33,571 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2021 kanë pësuar një rritje me 27.23%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 8.22% krahasuar me fundin e vitit 2020. Ecuria e vlerës neto të aseteve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar për dy vitet e fundit si dhe rritja për vitin 2021 krahasuar me 2020 jepet në tabelën e mëposhtme:


**Tabelë 11: Asetet neto të fondeve të pensionit vullnetar**

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	2020	2021	31.12.'20 - 31.12.'21
Asetet neto të tregut	3,603.27	4,584.54	27.23

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur ecuria e aseteve neto të tregut të fondeve të pensionit gjatë 5 viteve të fundit e shprehur në milionë lekë. Vlera e aseteve neto dhe vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka pasur një tendencë në rritje që prej licencimit të këtyre fondeve.

**Grafik 21: Ecuria në vite e asetëve neto të fondeve të pensionit**

(Në mln. lekë)



Asetet e këtij tregu në 31.12.2021 janë investuar kryesisht në obligacione të Qeverisë shqiptare. Investimet në obligacione të R.SH. përbëjnë 91.49% të totalit të asetëve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 21.56% krahasuar me fundvitin 2020. Pjesa tjetër e asetëve e këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme. Struktura e asetëve të këtij tregu gjatë dy viteve të fundit dhe ndryshimi i kësaj strukture jepet në tabelën e mëposhtme.


**Tabelë 12: Ndryshimi i strukturës së asetëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar, 31.12.2021 krahasuar me 31.12.2020**

Përshkrimi	Vlera (Në mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)	Pjesa ndaj totalit (Në %)	
	31.12.'20	31.12.'21		31.12.'20- 31.12.'21	31.12.'20
<b>Periudha</b>					
<b>Asetet neto të fondeve të pensionit</b>	<b>3,603.27</b>	<b>4,584.54</b>	<b>27.23</b>		
<b>Totali i asetëve të fondeve</b>	<b>3,618.80</b>	<b>4,598.98</b>	<b>27.09</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	83.26	301.81	262.48	2.30	6.56
Obligacione Thesari të RSH	3,461.31	4,207.68	21.56	95.65	91.49
Depozita bankare	-	-	-	-	-
Asete të tjera	74.22	89.50	20.58	2.05	1.95
<b>Totali i Detyrimeve të Fondeve</b>	<b>15.52</b>	<b>14.44</b>	<b>-6.97</b>	<b>0.43</b>	<b>0.31</b>




Në grafikun më poshtë është paraqitur ecuria e investimeve të tregut të фондеве të pensionit gjatë 5 viteve të fundit.

**Grafik 22: Ecuria e investimeve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar** (Në mln. lekë)




Detyrimet e фондеве të pensionit vullnetar përgjithësisht janë afatgjata, pasi anëtarët në фонде tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit. Për rrjedhojë edhe politika e investimeve për të gjitha фондеде të pensionit të cilat operojnë në treg është afatgjatë, duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Kjo politikë e investimeve të фондеве të pensionit synon në maturime afatgjata dhe vihet re se në fund të vitit 2021, pjesën më të madhe e zinin investimet në obligacione me afat maturimi 10-vjeçar, në masën 71.10%.

**Grafik 23: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar, 31.12.2021** (Në %)



Numri i anëtarëve që kanë kontribuar në fondet e pensionit vullnetar ka arritur në 33,571 më 31.12.2021. Ky numër anëtarësh është rritur me 8.22% në krahasim me 31.12.2020. Siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, numri i anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar ka vijuar tendencën rritëse nga viti në vit.

**Grafik 24: Ecuria e numrit të anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar** (Në numër)




Anëtarët në fondet e pensionit në 31.12.2021 ndahen në: 18,081 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar, 15,261 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre dhe 229 anëtarë janë përfshirë në planet individuale dhe profesionale njëkohësisht.

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për 31.12.2021, ku 53.86% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, 45.46% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit, kurse 0.68% bëjnë pjesë në planet individuale dhe profesionale.



**Grafik 25: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit, 31.12.2021** (Në %)



### Mbikëqyrja me bazë rrezikun dhe analiza e rreziqeve të tregut

Nëpërmjet metodologjisë me bazë rrezikun evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm. Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016, me miratimin e metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut, në vitin 2021, janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objekt zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

### 2.3.2 Inspektimet

Për tregun e fondeve të pensionit vullnetar, Autoriteti gjatë këtij viti ka kryer inspektime tematike tek të gjitha shoqëritë administruese në lidhje me informimin dhe transparencën e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit.

Fokusi i këtyre inspektimeve ka qenë verifikimi i zbatimit të bazës ligjore dhe rregullatore në lidhje me transparencën në informimin e anëtarëve gjatë shitjes së produktit të fondit të pensionit dhe kryerjes së aktivitetit të fondit. Disa nga çështjet që u verifikuan gjatë inspektimeve janë renditur si më poshtë:

- Transparenca në shitjen e produktit të fondit të pensionit dhe lidhja e kontratës;
- Informimi dhe transparenca ndaj anëtarit të fondit të pensionit:
  - Nëpërmjet mundësisë që i jepet çdo anëtar për të hyrë në llogarinë e tij individuale përmes kredencialeve të veta nga faqja e internetit të shoqërisë administruese;
  - Në lidhje me detyrimin e shoqërisë administruese për të raportuar te anëtarët e fondit të pensionit për mbarëvajtjen e fondit të pensionit;
  - Nëpërmjet njoftimit të anëtarëve 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit;
  - Nëpërmjet trajtimit të ankesave të anëtarëve të fondit të pensionit dhe përgjigjeve për kërkesat e anëtarëve për informim;
  - Njoftimi i anëtarëve në lidhje me ndryshimet që prekin fondin e pensionit dhe shoqërinë administruese.

Autoriteti pas çdo inspektimi ka lënë rekomandimet përkatëse për të cilat shoqëritë administruese kanë marrë masat për zbatimin e tyre.





Viti 2021 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket kuadrit ligjor e rregullator. Në mars të vitit 2021 u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili hyri në fuqi më datë 1 korrik 2021.

Nisma të rëndësishme ligjore, gjatë vitit 2021, janë ndërmarrë edhe në tregun e pensioneve vullnetare. Autoriteti hartoi Projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, i cili synon përafrimin me Direktivat evropiane, si edhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e tregut të fondeve private.

Në tregun e fondeve të investimeve dhe kapitaleve, Autoriteti ka vijuar punën për plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

### 3.1 Rregullimi i Tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive dhe Kapitalit

#### Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive

Gjatë vitit 2021, janë miratuar 4 rregullore në zbatim të Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të cilat plotësojnë kuadrin rregullativ për këtë treg.

- Rregullore nr. 108, datë 30.06.2021 “Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore e furnizuese”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për shoqëritë administruese të fondeve, depozitarët dhe shoqëritë audituese në lidhje me veprimtarinë e sipërmarrjeve dhe nënfondeve të licencuara kryesore dhe furnizuese;
- Rregullore nr. 107, datë 30.06.2021 “Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Shoqërive Administruese dhe Depozitarëve”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave lidhur me përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raportimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Shoqërive Administruese dhe Depozitarëve, në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare;
- Rregullore nr. 106, datë 30.06.2021 “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në Republikën e Shqipërisë;

- Rregullore nr. 2, datë 27.01.2021 “Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive që duhet të zbatohen nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët e licencuar, si dhe nga subjektet të cilave shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët i kanë deleguar aktivitetet përgjegjëse. Kjo rregullore përcakton gjithashtu kërkesat për kategorizimin e klientëve dhe trajtimin e klientëve nga shoqëritë administruese të fondeve dhe agjentët e tyre të shitjes.

### **Tregu i kapitalit**

Gjatë vitit 2021 Autoriteti është angazhuar për plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të Ligji nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Në kuadër të projektit SECO II, “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - Fokus zhvillimi i tregut të kapitaleve”, po punohet me konsulencë të huaj për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të fundit në zbatim të ligjit.

Në kuadër të zhvillimeve të reja teknologjike në industrinë e shërbimeve financiare, si dhe rritjes së kërkesës së subjekteve për të ofruar për klientët e tyre shërbime të investimit online përmes rrugëve elektronike të komunikimit, Bordi i Autoritetit me vendimin nr. 127, datë 28.07.2021, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”. Ndryshimet e miratuara konsistojnë në parashikimin e dokumentacionit shtesë (në procesin e licencimit apo ndryshimit të veprimtarisë) që duhet të paraqesin shoqëritë komisionere/bankat në rastin e ofrimit të shërbimeve të investimit përmes rrugëve elektronike të komunikimit.

### **Tregu financiar i bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë**

Miratimi i Ligji nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, vendosi kushtet për licencimin, monitorimin, mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, të agjentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Në vijim të punës për plotësimin e kuadrit nën ligjor që rregullon këtë treg Autoriteti ka hartuar dhe miratuar rregulloret si më poshtë:



- Rregullore nr. 211, datë 25.11.2021 “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital”, objekti i së cilës është përcaktimin e rregullave dhe procedurave të detajuara të licencimit, llojit të dokumenteve provuese, mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumenteve dhe detyrimet për raportim të subjekteve që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital;
- Rregullore nr. 210, datë 25.11.2021 “Për mjaftueshmërinë e kapitalit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave të detajuara në lidhje me përlogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si agjent TD, bursë DLT dhe kujdestar i portofolit të palëve të treta.

Gjithashtu janë nxjerrë për konsultim publik grupi i dytë i rregulloreve në zbatim të Ligjit nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe po vijohet me pjesën e mbetur të akteve deri në finalizimin e tyre.

### **3.2 Rregullimi i tregut të sigurimeve**

Viti 2021 shënoi zhvillime të rëndësishme në tregun e sigurimeve, përmes miratimit të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili sjell përmirësim të kuadrit ligjor dhe rregullator, si edhe harmonizim të legjislacionit në sigurime me direktivat evropiane.

Ligji nr. 32/2021, rregullon:

- Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit motorik për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- Sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
- Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të mjetit lundrues për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit/përdoruesit të avionit për dëmet e shkaktuara palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni.

Ligji synon të ulë numrin e drejtuesve të mjeteve të transportit që qarkullojnë të pa pajisur me kontratën e sigurimit të detyrueshëm. Gjithashtu ai synon të rrisë cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit dhe ka të parashikuar:

- Rritje të kufirit minimal të përgjegjësisë;
- Rritje të masës së dëmshpërblimit si dhe ulja e nivelit të shpenzimeve të marrjes në sigurim;

- Përmirësim të procedurave dhe afateve për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim nga ana e shoqërive të sigurimit në mënyrë që të shmangen problematikat dhe rastet abuzive;
- Procedura për zgjidhjen me mirëkuptimin midis palëve të përfshira në aksident, të rasteve të dëmeve materiale me një vlerë të vogël. Bazuar në “Raportin Evropian të Aksidenteve”, i zbatuar në shumë vende të Bashkimit Evropian, palët në aksident hartojnë vetë raportin miqësor për ngjarjen. Kjo praktikë e re adreson zgjidhje më të shpejtë të dëmshpërblimeve nga sigurimi i detyrueshëm motorik, që i takojnë fashës deri në 30.000 lekë.

Në zbatim të ligjit të ri, gjatë vitit 2021 janë hartuar dhe miratuar 9 rregullore, si më poshtë:

- Rregullore nr. 191, datë 26.10.2021 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave të detyrueshme mbi administrimin e Fondit të Kompensimit dhe mbi delegimin, trajtimin, pagesën dhe rimbursimin e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi;
- Rregullore nr. 190, datë 26.10.2021 “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të Kartonit Jeshil”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave mbi administrimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil, si dhe rregullave për trajtimin e dëmeve të Kartonit Jeshil;
- Rregullore nr. 189, datë 26.10.2021 “Për komisionet e ndërmjetësimit”, objekti i së cilës është përcaktimi i nivelit maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit;
- Rregullore nr. 159, datë 29.09.2021 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve” objekti i së cilës është përcaktimi i procedurave të funksionimit, identifikimit dhe raportimit të dhënave të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm në Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve, të instaluar në Qendrën e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm pranë AMF-së;
- Rregullore nr. 126, datë 28.07.2021 “Për llogaritjen e Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, të ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të Fondit të Kompensimit”, objekti i së cilës është të përcaktojë mënyrën e llogaritjes së Fondit të Kompensimit, kontributin e çdo anëtarit në vlerën minimale të Fondit të Kompensimit si dhe rastet e prekjes, ndërhyrjes dhe afatet e rivendosjes së kësaj vlere;
- Rregullore nr. 125, datë 28.07.2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, objekti i së cilës është përcaktimi i



rregullave, procedurave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohen nga kontrata e sigurimit:

- Rregullore nr. 105, datë 30.06.2021 “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, objekti i së cilës është përcaktimi i procedurave për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin elektronik të dhënave të dëmeve sipas parashikimeve të neneve 41 dhe 43 të Ligjit nr. 32/2021, në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit;
- Rregullore nr. 104, datë 30.06.2021 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, objekti i së cilës është përcaktimi i rolit mbikëqyrës, përmbajtjes, afateve, kërkesave për raportim dhe miratim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, në AMF;
- Rregullore nr. 103, datë 30.06.2021 “Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve Fond Kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021” objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave të administrimit dhe pagesave të praktikave, objekt i Fondit të Kompensimit, me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- Autoriteti me Vendimin nr. 214, datë 25.11.2021, ka miratuar disa ndryshime në Rregulloren nr. 159, datë 29.09.2021 “Për regjistrin elektronik *online* të shitjeve”.

### 3.3 Rregullimi i tregut të fondeve të pensionit vullnetar

Me qëllim përafrimin me Direktivën 2016/2341/KE “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II), standardet më të mira ndërkombëtare, si dhe përmirësimin e bazës ligjore që rregullon tregun e fondeve të pensionit privat me kontribute të përcaktuara, gjatë vitit 2021, Autoriteti hartoi draftin e Projektligjit “Për fondet e pensionit privat”.

Ky zhvillim ligjor ndërmerret në një kohë kur tregu i pensioneve kërkon harmonizim me direktivat e BE-së dhe nxitje me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në skemat private të pensioneve. Nevoja për hartimin e një ligji të ri në përputhje me direktivat e BE-së është theksuar edhe nga Këshilli e Evropës në takimin e njëmbëdhjetë, datë 22.04.2020 të Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca. KE për pensionet vullnetare ka dhënë si rekomandim përafrimin e bazës ligjore me Direktivën 2016/2341/KE “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II).

Projektligji “Për fondet e pensionit privat” rregullon:

- Licencimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë;
- Krijimin dhe veprimtarinë e fondeve të pensionit privat me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë;
- Licencimin dhe veprimtarinë e depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat;
- Mbikëqyrjen e shoqërisë administruese, fondeve të pensionit privat, depozitarit të aseteve të fondit të pensionit privat dhe të subjekteve të tjerë sipas këtij ligji;
- Veprimtarinë ndërkufitare të shoqërive administruese që ofrojnë fonde të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të këtij projektligji janë:

- Përafrimi dhe harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me Direktivën 2016/2341/KE “Për Veprimtarinë dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional” (IORP II);
- Sigurimi i një pensioni shtesë në momentin e daljes në pension;
- Garantimi i sigurisë së aseteve të fondit;
- Diversifikimi i portofolit të investimit të aseteve të fondit të pensionit;
- Rritja e kërkesave për transparencë dhe sigurimi i informacionit periodik për anëtarët e fondit;
- Krijimi i lehtësirave fiskale për anëtarët dhe përfituesit e fondit;
- Nxitja e qëndrueshmërisë dhe mirëqeverisjes së shoqërive administruese të fondit të pensionit;
- Rregullimi i veprimtarisë ndërkufitare të shoqërive administruese;
- Promovimi i fondeve të pensionit.



## Të tjera

Gjatë vitit 2021 janë miratuar, si dhe janë amenduar disa rregullore që gjejnë zbatim në të gjitha fushat e veprimtarisë së Autoritetit.

- Autoriteti hartoi Udhëzimin nr. 209, datë 25.11.2021 “Për procedurat e inspektimit në subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, i cili shfuqizon udhëzimin e mëparshëm nr. 2 datë 21.11.2007. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për inspektimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF. Procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim janë të unifikuara dhe i shtrijnë efektet ndaj të gjithë subjekteve në tregjet nën mbikëqyrje nga Autoriteti;
- Ndryshime dhe shtesa janë miratuar me Vendimin e Bordit nr. 256, datë 29.12.2021, dhe në Rregulloren nr. 155, datë 23.12.2014 “Për përcaktimin e elementëve të përlogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre”. Hyrja në fuqi e ligjeve të reja që rregullojnë tregun e kapitaleve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive diktoi nevojën e amendimit të rregullores së tarifave duke ndryshuar disa tarifa aplikimi, licencimi e mbikëqyrjeje, si dhe terminologjinë e përdorur;
- Në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, si dhe plotësimit të detyrimit për të miratuar procedurat e hollësishme të plotësimit dhe të ruajtjes së regjistrave të parashikuar nga ky ligj, Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 212, datë 25.11.2021 miratoi disa ndryshime në Rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga AMF”;
- Ndryshime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm, janë bërë edhe në akte të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e vetë Autoritetit. Gjatë vitit 2021 me Vendimin nr. 121, 30.06.2021, Bordi i Autoritetit miratoi disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 170, datë 14.08.2019 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”;
- Me qëllim plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti hartoi Rregulloren “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje, në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” e cila u miratua me Vendimin e Bordit nr. 239, 29.12.2021.

### **3.4 Licencimi dhe Qeverisja**

#### **3.4.1 Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

##### **Aktiviteti i Licencimit**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i cili lejon regjistrimin e shoqërisë komandite të sipërmarrjes së investimeve kolektive, si fond i investimeve alternative për klientë profesionistë dhe të kualifikuar, Autoriteti shqyrtoi dhe regjistroi 2 shoqëri komandite SIK, si fonde investimesh alternative ofruar vetëm për klientët profesionistë dhe të kualifikuar, “Sea Land Alternative Investment Fund” dhe “Green View Alternative Investment Fund”.

Gjatë vitit 2021, kanë përshtatur aktivitetin me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloreve të miratuara në zbatim të tij, një shoqëri administruese “Albsig Invest” sh.a. dhe një depozitar “Tirana Bank” sh.a.

Gjithashtu janë licencuar 2 fonde investimi me ofertë publike “Abi Flex Euro” dhe “Abi Flex USD” nën administrimin e shoqërisë “ABI Invest” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.

Aktualisht në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetet 6 shoqëri administruese nga të cilat 2 janë shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike, 2 janë shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, 1 është shoqëri administruese vetëm e fondeve të pensionit vullnetar dhe 1 është shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike dhe e fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Shoqëritë administruese të fondeve, administrojnë 11 SIK në formën ligjore të fondit të investimit, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, 4 fonde pensioni vullnetar dhe 2 fonde të investimit alternativ për klientë profesionistë dhe të kualifikuar.

Në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetin e Depozitarit të fondeve 6 banka, nga të cilat 3 janë të licencuara si depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, 2 janë depozitar të fondeve të pensionit vullnetar dhe 1 bankë është depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar, i sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe i fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.





Të dhënat mbi shoqëritë administruese, sipërmarrjet e investimeve kolektive, fondet e pensionit vullnetar dhe depozitarët, jepen në tabelën e mëposhtme:

**Tabelë 13: Të dhëna mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e fondeve** (Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>
<b>Shoqëri Administruese:</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>6</b>
Shoqëri Administruese të SIK me ofertë publike	-	1	1	2	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar	1	1	1	1	1
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike	2	2	3	2	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	-	1	1
<b>Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (Fonde investimi)</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>11</b>
Fonde Investimi Alternativ	-	-	-	-	2
<b>Fonde Pensioni Vullnetar</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>4</b>
<b>Depozitarë të fondeve:</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>6</b>
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar	3	3	2	2	2
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar dhe Fondeve të Investimit	2	2	4	3	3
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe Fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	-	1	1

### Verifikim i përshtatshmërisë së subjekteve sipas Ligjit të SIK


Gjatë vitit 2021, është realizuar përshtatshmëria e 5 Shoqërive Administruese të Investimeve Kolektive, 4 Depozitarëve dhe 6 Fondeve të Investimit. Procesi i përshtatshmërisë ishte kërkesë e Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Të gjitha shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe bankat depozitare kanë depozituar në Autoritet raportin e detajuar të përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit nr.56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Gjatë verifikimit të procesit të përshtatshmërisë, Autoriteti ka kryer shqyrtimin e standardeve të qeverisjes së brendshme, sipas praktikave më të mira, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme lidhur me:

- Përputhshmërinë në vijimësi me kërkesat mbi licencimin;
- Kushtet e veprimitarisë për shoqërinë administruese të fondeve;
- Parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit si dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshme me qëllim mosçenimin e interesave të investitorëve të SIK;
- Kërkesat për transparencën dhe dhënien e informacioneve shpjeguese;
- Kërkesat për administrimin e rrezikut dhe të likuiditetit;
- Detyrimet e raportimit për shoqëritë administruese dhe fondet e administruara prej tyre;
- Kërkesat për administrimin e llojeve të veçanta të fondeve të administruara;
- Praktikrat e shitjes, transparencën dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për investitorët;
- Marketimin e fondeve në administrim nga shoqëria administruese;
- Programet e trajnimit të vazhdueshëm për të garantuar që të gjithë punonjësit janë të trajnuar siç duhet, i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë dhe pajisen me manuale për procedurat.
- Procedurat administrative dhe kontabël dhe atyre për vlerësimin real të rrezikut, sistemeve që mbulojnë aktivitetin e shoqërisë administruese dhe masave mbrojtëse për sistemet e përpunimit të informacionit, si dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
- Kërkesat për përshtatshmërinë dhe aftësinë e personave dhe personelit kyç të shoqërive administruese dhe depozitarëve sipas kërkesave të Ligjit nr. 56/2020, dhe akteve rregullative të miratuar nga Autoriteti.

Në përfundim të këtij procesi, Bordi i Autoritetit ka marrë vendimet përkatëse dhe ka përmbyllur brenda vitit 2021 përshtatshmërinë e shoqërive administruese të SIK me ofertë publike, fondeve të investimeve dhe depozitarët e tyre, duke i shoqëruar me formatin e ri të licencës.



## Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, shoqëritë administruese janë të organizuara sipas sistemit të organizimit me një nivel. Autoriteti miratoi 3 emëtime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive administruese të fondeve, 5 riemëtime në këto funksione, si dhe një personel kyç të depozitarit.

Gjatë vitit 2021 Autoriteti ka miratuar delegimin e disa funksioneve për 4 shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar.

**Tabelë 14: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar**

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri administruese	6	
Aksionarë gjithsej	17	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese:</i>		100
nën 10%	7	41.18
mbi 10% nën 20%	2	11.76
mbi 20% nën 33 %	1	5.88
mbi 33% nën 50%	1	5.88
mbi 50%	6	35.29
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	8	47.06
Aksionarë vendas	9	52.94
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit:</i>		100
Aksionarë individë	9	52.94
Aksionarë shoqëri	8	47.06

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime statutorë të subjekteve që vepronë në këtë treg.

### 3.4.2 Tregu i kapitalit

#### Aktiviteti i Licencimit

AMF licencoi shoqërinë “Banka Union” sh.a. për ofrimin e 3 shërbimeve të investimit-marje/transmetim urdhrash; ekzekutim urdhrash në emër të klientëve; tregtim për llogari të vet, për 2 instrumente financiarë-tituj të transferueshëm e instrumente të tregut të parasë si edhe për ofrimin e 1 shërbimi ndihmës, ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Autoriteti miratoi përshtatshmërinë e aktivitetit me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij si edhe zgjerimin e licencës me instrumente financiare dhe shërbime ndihmëse për 3 banka-shoqëri komisionere, “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., “Banka e parë e investimeve, Albania” sh.a., dhe “Banka OTP Albania” sh.a.

Bordi i AMF-së, me Vendimin nr. 193, datë 26.10.2021, i dha të drejtën shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a. për kryerjen e shërbimeve të investimit **online**, nëpërmjet platformës “Smart Invest”. Kjo është platforma e parë e shërbimeve të investimeve online që i jep akses të drejtpërdrejtë investitorëve shqiptarë, duke i ofruar mundësinë e investimit në aksione të kompanive ndërkombëtare dhe në një sërë instrumentesh të tjera financiare. Përafrimi i kuadrit ligjor e rregullator të AMF-së me legjislacionin e BE-së, konkretizoi dhe krijoi mundësi të reja të ndërlidhjes me tregjet financiare ndërkombëtare. Ligji i ri nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit” rrit standardet dhe kërkesat për transparencë dhe përshtatshmëri, si elementë thelbësorë të nxitjes së besimit dhe pjesëmarrjes së investitorëve në tregjet e kapitalit.

AMF licencoi shoqërinë “Banka Union” sh.a. për ofrimin e 3 shërbimeve Gjatë vitit 2021 është hequr njohja dhe është çregjistruar shoqëria “OnTop-Securities” sh.a., si agjent i lidhur i brokerit të huaj dhe është pezulluar regjistrimi i dy shoqërive “Vertex Securities” sh.a., dhe “On Top Securities” sh.a., si agjent i lidhur i brokerit të huaj.

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe rregullatore, Autoriteti miratoi 1 emërim dhe 6 riemërime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive komisionere.



Tabela më poshtë paraqet subjektet që veprojnë në vitin 2021 në tregun e kapitaleve.

**Tabelë 15: Të dhëna historike mbi subjektet që veprojnë në tregun e kapitalit** (Në numër)

Subjekte	2017	2018	2019	2020	2021
Bursë titujsh	1	1	1	1	1
Shoqëri komisionere/Banka	17	17	14	12	13
<i>Nga këto:</i>					
<i>Banka që ofrojnë shërbim ndihmës për ruajtjen dhe administrimin e instrumenteve financiare</i>	9	9	9	9	10
Regjistrar titujsh	1	1	2	2	2
Agjentë të lidhur të shoqërive komisionere të huaja	4	3	5	4	2

### Verifikim i përshtatshmërisë së subjekteve në tregjet e kapitalit

Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" parashtrori detyrimin e subjekteve për përshtatshmërinë e veprimtarisë së tyre me kërkesat e ligjit të ri. Subjektet iu nënshtruan një procesi të plotë të rishikimit dhe përditësimit të rregullave dhe procedurave të tyre operacionale, rishikimit të kontratave me klientin, apo hartimit të rregullave dhe procedurave shtesë në këndvështrimin e kërkesave të reja ligjore.

Pjesë e përshtatshmërisë ishte edhe implementimi i procesit të certifikimit të personelit të dedikuar për të ofruar shërbime investimi (personelit kyç) nga vetë subjektet dhe pajisja e tyre me dokumentin për aftësi dhe përshtatshmëri. Gjatë procesit të përshtatshmërisë, Autoriteti ndërmoi një analizë të detajuar të dokumentacionit të depozituar nga subjektet dhe verifikimit të procesit të certifikimit të personelit të kryer nga vetë ato.

Në zbatim të kërkesave të reja ligjore dhe rregullative, shoqëritë hartuan një set rregullash të reja të cilat synojnë të vendosin standarde në funksion të përmirësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të investimeve. Në këtë drejtim, shoqëritë komisionere/bankat kanë hartuar për herë të parë dokumentin e politikave të ekzekutimit më të mirë të urdhrit të klientit, ku përcaktohet mënyra se si këto subjekte do të bëjnë përpjekjet maksimale për të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm, gjatë kryerjes dhe ekzekutimit të një transaksioni me tituj në emër të klientit.

Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e reja ligjore dhe rregulloren e Autoritetit subjektet depozituan procedurën dhe metodologjinë për mënyrën e testimit dhe vlerësimit të klientit në lidhje me përshtatshmërinë e tij ndaj shërbimit të investimit dhe instrumentit financiar që kërkohet të ofrohet. Autoriteti ndërmoi edhe verifikime në vend pranë disa prej subjekteve për mënyrën e funksionimit të sistemeve në ofrimin e shërbimeve të investimit dhe shërbimeve ndihmëse në përmbushje të kërkesave rregullative. Pjesë e procesit të përshtatshmërisë ishte riformatimi i licencave të subjekteve, me qëllim harmonizimin me terminologjinë, shërbimet dhe instrumentet financiare, sipas përcaktimeve të ligjit të ri për tregjet e kapitalit.

### **3.4.3 Tregu i sigurimeve**

#### **Aktiviteti i licencimit**

Aktiviteti licencues i AMF-së në tregun e sigurimeve u fokusua kryesisht në licencimin/miratimin e ndërmjetësve në sigurime (agjentë); rinovim licence aktuar si edhe licencim e rinovim licence të vlerësuesve të dëmeve.

#### **Shoqëri sigurimi**

Aktualisht në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 12 shoqëri sigurimi nga të cilat 8 në sigurimin e Jo-Jetës dhe 4 shoqëri në sigurimin e Jetës. Ky numër nuk ka ndryshuar që prej vitit 2019.

#### **Ndërmjetës në sigurime**

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet si broker në sigurime ose si agjent në sigurime. Brokerimi në sigurime mund të kryhet nga individët e licencuar si broker në sigurime si broker fizik i pavarur, nga shoqëritë e brokerimit dhe bankat e licencuara për të ushtruar këtë veprimtari nëpërmjet brokerit të licencuar.

Në tregun e sigurimeve aktualisht janë të licencuara për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime 14 shoqëri brokerimi, 5 banka dhe 4 brokera fizik. Për vitin 2021, nuk ka ndryshime të këtyre shifrave.

Nga 14 shoqëritë e brokerimit, 7 prej tyre dhe 1 bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa 4 shoqëri ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëritë e tjera, si edhe 5 bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy fushat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

**Tabelë 16: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit***(Në numër)*

Viti	2017	2018	2019	2020	2021
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	8	9	9	8	8
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	5	6	6	7	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	3	4	4	4	4
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>19</b>

Autoriteti miratoi 151 persona fizikë (agjentë) për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime si dhe licencoi 14 subjekte juridike për të vepruar si agjentë në sigurime. Në tregun e sigurimeve janë të miratuar 863 individë për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe janë të licencuar 53 subjekte juridike nga të cilat 4 janë banka.

**Tabelë 17: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime***(Në numër)*

Agjent në sigurime	Të licencuar në fund të vitit 2020	Licenca të reja në 2021	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2021	Të licencuar në fund të vitit 2021
Persona juridikë	44	14	5	53
<i>Nga këto, banka</i>	4			4
Person fizikë	756	151	44	863

### Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 50 individë si vlerësues dëmsh në sigurime, nga të cilët 18 individë e ushtrojnë këtë veprimtari si të punësuar pranë një shoqërie sigurimi dhe 32 individë si vlerësues të pavarur.

Në 2021 janë licencuar 2 individë si vlerësues dëmsh, janë rinovuar 9 licenca, u përfundoi afati i licencës 6 individëve si dhe Autoriteti mori masa duke i hequr licencën si vlerësues dëmsh në sigurime për 8 individë për mospërmbushje të kërkesave ligjore.

Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit (i punësuar/i pavarur) dhe llojit të licencës (për dëme materiale dhe/ose shëndetësore) jepen në tabelën e mëposhtme.

**Tabelë 18: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurim** (Në numër)

<i>Vlerësues sipas statusit/ llojit të licencës</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2020</i>	<i>Rinovuar licenca në 2021</i>	<i>Licenca të reja në 2021</i>	<i>Përfunduar afati i licencës në 2021</i>	<i>Hequr licenca në 2021</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2021</i>
<b>Sipas statusit të personit</b>						
Të pavarur	31	6	1	1	5	32
Të punësuar	22	3	1	5	3	18
<b>Sipas llojit të Licencës</b>						
Dëme materiale	3	3		1	1	4
Dëme shëndetësore	15	3	1	2		17
Dëme materiale dhe shëndetësore	35	3	1	3	7	29
<b>TOTALI</b>	<b>53</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>50</b>

### Qeverisja

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë e sigurimit me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Nga 12 shoqëri sigurimi në fund të vitit 2021, 10 prej tyre ishin të organizuara sipas sistemit me dy nivele dhe vetëm 2 shoqëri me një nivel.

Autoriteti miratoi 8 emërimet në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive të sigurimit, si dhe 15 riemërimet në këto funksione.

Shoqëritë e sigurimit janë kryesisht me kapital vendas, konkretisht nga 12 shoqëri sigurimi 9 janë me kapital vendas dhe 3 me kapital kryesisht të huaj. Gjithashtu, nga 12 shoqëri sigurimi 11 prej tyre kanë aksionar influencues që zotëron mbi 50% të aksioneve.





**Tabelë 19: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit**

(Në numër)

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri sigurimi	12	
Aksionarë gjithsej	37	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	18	50
mbi 10% nën 20%	4	13.16
mbi 20% nën 33 %	3	5.26
mbi 33% nën 50%	1	2.63
mbi 50%	11	28.95
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	2	5.26
Aksionarë vendas	35	94.74
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	28	76.32
Aksionarë shoqëri	9	23.68

Autoriteti ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutore, sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabelë 20: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore**

(Në numër)

<i>Arsyeja e ndryshimit të Statutit</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>2021</i>
Statut i ri/ndryshime të tjera	2	3	1	-	-
Rritje kapitali	1	3	1	2	3
Ndryshim i strukturës aksionare	1	1	-	3	1

### 3.5 Masat mbikëqyrëse dhe administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe Ligji “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” parashikon masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave dhe veprimeve, që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Bordi Autoritetit, për shkak të kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19, me qëllim ruajtjen e nivelit të likuiditetit dhe treguesve financiarë të shoqërive të sigurimit, mori Vendimin nr. 68 datë 28.04.2021, duke vendosur pezullimin e shpërndarjes së fitimit të shoqërive të sigurimit për vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, Bordi AMF-së ka marrë 34 vendime për masa administrative e korigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiarë, nga inspektimet e kryera në vend nga Autoriteti, si edhe pezullim ose revokim licencash për ushtrim aktiviteti.

**Në tregun e sigurimeve janë marrë 26 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten:**

- 17 vendime për masa korigjuese dhe sanksione me gjobë (15 shoqëri sigurimi dhe 2 shoqëri agjentësh);
- 2 vendime me pezullim licence ndaj agjentëve individ;
- 1 refuzim rinovim licence dhe 1 revokim licence për vlerësues dëmsh në sigurime;
- 6 pezullime licencash për vlerësues dëmsh në sigurime.

**Në tregun e titujve janë marrë 4 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten:**

- Ndaj 3 agjentëve të lidhur të shoqërisë së brokerimit të huaj është pezulluar regjistrimi;
- Ndaj 1 agjenti të lidhur të shoqërisë së brokerimit të huaj është hequr njohja dhe regjistrimi.

Në tregun e fondeve të pensionit vullnetar janë marrë 4 vendime, të cilat janë katër masa mbikëqyrëse ndaj shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar.



## Vendimet e ankimuar si dhe vendimet e pranuar nga gjykata

Gjatë vitit 2021, në gjykatë janë depozituar ankime ndaj 3 vendimeve të Bordit të Autoritetit. Një vendim gjykate është i formës së prerë në favor të Autoritetit, ndërsa dy të tjerat janë në proces gjyqësor në shkallë të parë.

### **Masat e marra si pasojë e pandemisë globale COVID-19**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar kohëzgjatjes së situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19, e cila paraqiti disa sfida për tregjet financiare jobankare, në funksion të përmbushjes së objektivit parësor të rregullimit dhe mirëfunksionimit të tregjeve nën mbikëqyrje, ka monitoruar me kujdes veprimtarinë e këtyre tregjeve, duke kërkuar marrjen e masave dhe kujdes të shtuar për kalimin e situatës në mënyrën më efektive të mundshme.

Gjatë kësaj periudhe, AMF ka dhënë kontribut aktiv duke u mbështetur në praktikat më të mira të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të BE-së, objektivi i të cilave ka qenë edhe adresimi i situatës të krijuar nga COVID-19.

Gjatë monitorimit të zhvillimeve në tregun e sigurimeve, për vitin 2021, ka rezultuar se tregu i sigurimeve ka arritur të përballojë situatën e vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19 dhe paraqitet i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar.

Referuar raportit të stabilitetit financiar të dhjetorit 2020, të Autoritetit Evropian Rregullator të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), pas një analize lidhur me efektet e pandemisë Covid-19 në tregun evropian të sigurimeve, rekomandohet që tregu i sigurimeve duhet të marrë në konsideratë që çdo shpërndarje e dividendëve dhe shpërblimeve variabël të mos cenojë treguesit e shëndetit financiar, me qëllim mbajtjen e tyre brenda kërkesave ligjore duke garantuar mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

## Kapitulli 4

### Proceset Integruese dhe Bashkëpunimi Ndërinstitucional

#### 4.1 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

##### Roli i AMF-së në Integrimin Evropian

Autoriteti ka vijuar me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raport e Progresit të Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.


Komisioni Evropian, në Progres Raportin për Shqipërinë, ka vlerësuar miratimin e Ligjit 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Raporti nënvizon se “... është bërë progres në lidhje me rekomandimet e vitit të kaluar përmes miratimit të ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Raporti thekson se ligji i cili hyri në fuqi në korrik 2021 është në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Në Progres Raport evidentohen ligjet e reja të miratuara për tregjet e kapitalit, sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe tregjet financiare të bazuara në regjistrat e shpërndarë. Dokumenti konstaton se në zbatim të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, janë miratuar aktet nënligjore për investimet kolektive, rastet e pezullimit, menaxhimit të rrezikut dhe procedurat e licencimit. Gjithashtu në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit janë miratuar 5 rregullore. Këto akte përafrojnë më tej kuadrin ligjor të Shqipërisë me Direktivën *MiFID II* dhe legjislacionin e BE-së për transparencën, manipulimin e tregut, prospektet, mbi shlyerjen dhe depozitarët qendrorë të titujve.

Progres Raporti i Komisionit Evropian përmend gjithashtu masat e marra nga Autoriteti për të garantuar stabilitetin financiar të tregjeve në kuadër të pandemisë COVID-19, duke veçuar vendimin e Bordit për pezullimin e shpërndarjes së fitimit të vitit 2020 nga shoqëritë e sigurimit, në formën e dividendit apo në çdo formë tjetër pagesash.

Në kuadër të përafritimit të legjislacionit me direktivat e BE-së, AMF hartoi draftin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14.12.2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)”. Përputhja me këtë direktivë është rekomandim i Nënkomitetit XI “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca”. Projektligji i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila e ka publikuar për konsultim publik.

Autoriteti në cilësinë e kryesuesit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, në bashkëpunim me institucionet kontribuese në këtë kapitull, Banka e Shqipërisë (BSH), Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ),



Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT), ka zhvilluar takime të GNPIE-së, duke përgatitur materialet përkatëse si dhe ka marrë pjesë edhe në takimet e GNPIE-ve të kapitujve të tjerë ku Autoriteti është kontribues, Kriteri Ekonomik, Kapitulli 2- Liria e lëvizjes së punëtorëve, Kapitulli 3 - Liria për të ofruar shërbime, Kapitulli 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, Kapitulli 6 - Legjislacioni për shoqëritë tregtare, Kapitulli 17 - Politika ekonomike dhe monetare, Kapitulli 18- Statistikat dhe Kapitulli 28 - Mbrojtja e konsumatorit.

Në kuadër të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 janë realizuar dy raportime për progresin e bërë nga Autoriteti, sipas pyetjeve të bëra nga ekspertët e KE-së, për Kapitullin 9 si dhe kapitujt ku AMF është kontribues.

Janë realizuar 11 takime me Kryenegociatorin ku është raportuar mbi çështje që lidhen me Kapitullin 9. Janë hartuar raportime javore dhe tremujore për Kryenegociatorin, mbi ecurinë e proceseve të integritit si dhe realizimin e akteve ligjore të parashikuara në PKIE 2021-2023 për kapitullin ku Autoriteti është kryesues.

Është monitoruar rregullisht zbatimi i MSA-së, si dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Përfaqësues nga Autoriteti kanë marrë pjesë në takimet e nënkomiteteve përkatëse si dhe kanë kryer raportime të detajuara në kuadër të integritit evropian, më konkretisht:

- Takimi i 12-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit, 27 maj 2021;
- Takimi i 13-të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomike – Financiare & Statistikat, 11-12 nëntor 2021.

AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si institucioni koordinues në procesin e integritit evropian. Janë përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Hartimi dhe miratimi i akteve të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE) për periudhën 2021-2023 është ndjekur në vazhdimësi. AMF dhe institucionet kontribuese hartuan PKIE për vitin 2022-2024 për Kapitullin 9.

## 4.2 Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

### **Masat e marra nga AMF në adresim të rekomandimeve të lëna nga komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës si dhe zbatimi i Planit të veprimit të ICRG/FATF**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka vijuar adresimin e rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, në lidhje me masat e marra kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Autoriteti është pjesë e grupit ndërinstitucional, ngritur me Vendimin nr.1, datë 19.2.2020 të Komitetit të Bashkëndimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, për ndjekjen dhe përbushjen e rekomandimeve të lëna nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) dhe Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (ICRG). AMF ka dhënë kontribut dhe ka zbatuar Planin e Veprimit të ICRG/FATF (Shkurt 2020-Shkurt 2022).

Në zbatim të Planit të Veprimit ICRG/FATF, janë kryer inspektime lidhur me verifikimin e përputhshmërisë së subjekteve raportuese në kuadër të verifikimeve me kampion, bazuar në analizën e rrezikut të Personave Juridik si dhe verifikimin e të dhënave të depozituara nga formularët e vetëvlerësimit (*off-site*), për vitin 2020.


### **Inspektimet e kryera gjatë vitit 2021 në kuadër të PPP/FT**

Gjatë vitit 2021 janë kryer në total 9 inspektime, nga të cilat një është realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), dhe më konkretisht:

- 4 pranë shoqërive të sigurimit të jetës dhe risigurimit;
- 2 pranë bankave që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë;
- 2 pranë shoqërive administruese (1 pranë Shoqërisë Administruese për Fondin e Pensioneve dhe Fondin e Investimeve dhe 1 pranë Shoqërisë Administruese për Fondin e Investimeve).
- 1 pranë agjentit në sigurime, që vepron në emër dhe për llogari të një shoqërie sigurimi Jete;

Inspektimet janë kryer sipas planit të punës dhe në përfundim të tyre nuk u konstatuan mangësi dhe nuk u lanë rekomandime për subjektet.

Gjatë vitit 2021, është bërë kategorizimi i rrezikut për subjektet e ligjit për PPP/FT, nën mbikëqyrjen e Autoritetit, bazuar në formularët e vetëvlerësimit për vitin 2020. Për subjektet banka që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë është shkëmbyer informacion me



Bankën e Shqipërisë, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes dy institucioneve. Rezultati i analizës për kategorizimin e rrezikut, dalë nga matrica e vlerësimit të kriterit, për 11 subjektet, ka rezultuar “Nivel i Ulët i Rrezikut”. Një informacion përmbledhës për rezultatet e rrezikut i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si autoritet përgjegjës.

### **Trajnime për PPP/FT**

Lidhur me forcimin e kapaciteteve të AMF-së, për PPP/FT, stafi i Autoritetit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh gjatë vitit 2021, të organizuara nga Këshilli i Evropës, IOSCO, GIZ, etj.

Gjithashtu punonjësit e Autoritetit kanë marrë pjesë në një cikël trajnimesh të zhvilluar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), pjesë e dy projekteve të asistencës teknike:

- “Këshillim dhe asistencë për AMF-në në zhvillimin e kuadrit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/FT) në lidhje me asetet virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të aseteve virtuale”;
- “Për zhvillimin e kuadrit mbikëqyrës në lidhje me kryptoasetet dhe ofruesit e shërbimeve të kryptoaseteve”.

### **4.3 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar**

Edhe gjatë vitit 2021, Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me organizatat, shoqatat, institucionet financiare, partnerë dhe donatorë, si edhe me autoritetet homologe rajonale dhe evropiane. AMF ka zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet homologe evropiane nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit, shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e mbikëqyrës, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, rregullimit të tregjeve si edhe garantimit të një mbikëqyrjeje të konsoliduar të tregjeve financiare jobankare.

### **Bashkëpunime me Autoritete dhe Institucione Homologe**

AMF bashkëpunon dhe ka marrëdhënie të mira me institucionet e huaja homologe që rregullojnë dhe mbikëqyrin tregjet financiare jobankare. Bashkëpunimi është materializuar me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me shumë institucione rregullatore homologe. Përfitimi kryesor nga këto marrëveshje është vendosja e marrëdhënieve, lehtësimi i shkëmbimit të informacionit dhe adoptimi i praktikave më të mira ndërkombëtare të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare.

Bashkëpunimi i AMF-së me **Bankën Qendrore të Kosovës (BOK)** vijoi edhe gjatë vitit 2021. Marrëveshja e nënshkruar në tetor 2020 mes AMF dhe BOK kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të mirërregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Nëpërmjet këtij Memorandumi, autoritetet forcuan bashkëpunimin e tyre në çështjet që lidhen me grupet e sigurimit të cilat ushtrojnë veprimtari në të dy vendet duke adresuar çështje e problematika të shfaqura nga subjektet nën mbikëqyrje.

AMF ka një bashkëpunim të mirë me **Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA)**. Marrëveshja e Mirëkuptimit midis dy institucioneve, e cila është në fuqi që prej vitit 2010, ndihmon dhe rrit efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve në të dy vendet, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë së shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AMF dhe **Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA)**, në shkurt 2021 nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy autoriteteve rregullatore. Marrëveshja e re, krahas tregjeve të kapitalit, zgjeron bashkëpunimin edhe me tregun e sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare, rregullon shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes, si edhe përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy autoriteteve. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton linja të qarta bashkëpunimi mes AMF dhe HANFA në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare jobankare.

AMF në vazhdimësi bashkëpunon dhe shkëmben informacione me **Autoritetin Austriak të Tregut Financiar (FMA)** me qëllim mbikëqyrjen efektive të grupeve të sigurimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun shqiptar si pjesë e grupeve ndërkombëtare të sigurimeve. Në mars të vitit 2021, AMF mori pjesë në mbledhjet virtuale të kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit që operojnë në vendin tonë, organizuar nga FMA. Takimi u fokusua tek ndikimet që solli situata e pandemisë COVID-19 përgjatë vitit 2020 në tregun e sigurimeve, ndryshimet në modelet e biznesit dhe ridimensionimin e planeve të vijimësisë së veprimtarisë. Gjatë një sesiioni të veçantë të zhvilluar me vendet e rajonit, AMF paraqiti ecurinë e treguesve financiarë të grupeve austriake të sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet AMF-së dhe **Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve së Sllovenisë (AZN)** për bashkëpunimin reciprok, edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave më të mira të dy vendeve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve. AMF mori pjesë dhe u prezantua me një punim në konferencën "Sigurimet gjithpërfshirëse në rajonin CEET" të organizuar nga AZN në bashkëpunim me IAIS, A2ii dhe Fondacionin Munich Re, në shtator 2021. Në këtë konferencë morën pjesë 188 pjesëmarrës nga 44 vende.





## **Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare e Rregullatore**

**Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar** kanë mbështetur në vijimësi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si partnerë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky bashkëpunim i shërben forcimit institucional, përmes mbështetjes për organizimin e trajnimeve nga ekspertët ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e kapaciteteve si të stafit të AMF-së, ashtu edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar. AMF ka përfituar asistencën e FMN-së në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve mbikëqyrëse për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë (tregjet e kriptomonedhave) dhe parandalimin e pastrimit të parave përmes veprimtarive të lidhura me to. Në takimet me ekspertët e FMN-së morën pjesë edhe zyrtarët nga AKSHI, DPPPP, Policia e Shtetit si dhe palë të interesuara nga sektori bankar duke i shërbyer veprimtarisë së koordinuar për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit financiar jobankar.

Gjatë vitit 2021, Autoriteti mori pjesë në takimet vjetore *online* me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Diskutimet e këtyre takimeve u përqendruan në ecurinë e ekonomisë shqiptare, situatën në tregjet financiare, si edhe pritshmëritë lidhur me treguesit ekonomikë për të ardhmen. FMN dhe BB vlerësuan qëndrueshmërinë dhe rezistencën e tregjeve financiare ndaj efekteve të pandemisë.

## **Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)**

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, mbrojtjen e të siguruarve, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global.

Një nga prioritetet e bashkëpunimit me IAIS ishte monitorimi i zhvillimeve në kushtet e pandemisë COVID-19 dhe koordinimi me organet e tjera të përcaktimit të standardeve dhe FSB (Komiteti i Stabilitetit Financiar) për të vlerësuar ndikimin e COVID-19 në tregun e sigurimeve në botë. AMF, gjatë vitit 2021 ka marrë pjesë aktive në takimet e nivelit të lartë, Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore, Komiteteve Teknike, Seminarin Global dhe Konferencën Vjetore organizuar në format virtual. Autoriteti ka pasur komunikime të vazhdueshme në drejtim të përfundimit të procesit për nënshkrimin e MMoU-së me IAIS.

Objektivi i Autoritetit për nënshkrimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe të Bashkëpunimit (MMoU) me IAIS është të krijojë një bazë formale për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet autoriteteve nënshkruese lidhur me mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve kur lindin aspekte ndërkufitare. Në të përfshihen kërkimi dhe shkëmbimi

i informacionit për veprimtarinë e shoqërive të sigurimit të mbikëqyrura nga të gjitha autoritetet nënshkruese anëtare të IAIS-it.

### **Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO)**

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s që prej vitit 2009. AMF merr pjesë në mbledhjet e Komiteteve IOSCO-s.

Në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh MMoU, AMF ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga IOSCO në bashkëpunim me autoritetet homologe, anëtare të IOSCO-s dhe institucionet financiare me të cilat bashkëpunon kjo organizatë.

MMoU u krijua në vitin 2002 për të vendosur standardet për bashkëpunim ndërkombëtar mes shteteve nënshkruese. Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit shumëpalësh shtetet anëtare të IOSCO-s konsultohen, bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion në funksion të zhvillimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare jobankare. IOSCO është një organizatë ndërkombëtare që mbledh së bashku pjesën më të madhe të rregullatorëve të titujve në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e titujve. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon standardet ndërkombëtare për rregullimin e tregut të titujve.

### **Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)**

AMF është anëtare me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të kësaj organizate që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004 me iniciativë të OECD-së, Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), me qëllim përfaqësimin e interesave të enteve rregullatorë të pensioneve private.

Gjatë vitit 2021, midis AMF-së dhe IOPS-it ka patur një bashkëpunim të mirë nëpërmjet rekomandimeve dhe planeve të veprimit për përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19, duke patur si prioritet përmbushjen e udhëzimeve *ad-hoc* bazuar në planin e veprimit të grupit të punës të pensioneve private. AMF ka kontribuar në plotësimin e pyetësorëve lidhur me masat e marra dhe politikat e ndjekura për mbrojtjen e konsumatorëve, në rastin e situatave emergjente. Njëkohësisht, Autoriteti ka kontribuar si çdo vit në raportimet e përvitshme lidhur me indikatorët, statistikën, tendencat dhe ndryshimet e fondeve të pensioneve.

Gjatë vitit 2021 AMF mori pjesë në takimet e nivelit të lartë, Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore dhe Komiteteve Teknike të zhvilluara *online*.



#### 4.4 Projekte

##### **Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve”**

AMF, gjatë vitit 2021, ka punuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, për realizimin sipas planit të zbatimit të komponentëve të projektit të financuar nga SECO dhe mbështetur nga Banka Botërore. Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF në forcimin e kapaciteteve të saj në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit, si dhe të mbështesë zhvillimin e tregut e kapitalit përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit financiar dhe nxitjes së inovacionit financiar. Ky projekt financohet nga granti i dhënë nga Oeveria e Konfederatës Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO), dhe mbështetet nga Banka Botërore. Projekti pritet të përfundojë në dhjetor 2022.

Fushat kryesore të asistencës teknike janë:

- Fuqizimi i funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Mbështetje për përgatitjen e rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse në lidhje me ligjet e miratuara rishtazi për tregjet e kapitalit në Shqipëri;
- Fuqizimi i mbikëqyrjes me bazë rrezikun për tregjet e kapitalit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për të monitoruar dhe mbikëqyrur tregjet e letrave me vlerë;
- Mbështetja e AMF-së në punën për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar.

Gjatë vitit 2021 është punuar në drejtim të zbatimit të komponentëve të projektit, sipas planit të punës së dakordësuar. Grupi i punës në AMF së bashku me konsulentët e projektit kanë kryer një punë intensive në drejtim të hartimit të rregulloreve të cilat rrjedhin nga miratimi i ligjit të ri për tregun e kapitaleve. Këto rregullore priten të përfundojnë dhe miratohen gjatë fillimit të vitit 2022.

##### **Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve” (2019-2022)**


Ky projekt ka si objektiv të forcojë kapacitetet e AMF-së për të rregulluar dhe mbikëqyrur tregun e sigurimeve dhe të forcojë zhvillimin e tregut. Gjatë vitit 2021, grupi i punës në AMF së bashku me konsulentët, kanë punuar sipas planit të zbatimit të projektit,

në realizimin e komponentëve për të forcuar kapacitetin rregullator dhe mbikëqyrës të sigurimeve. Më konkretisht, është punuar në fushat e mëposhtme:

- Metodologjia e treguesve të rrezikut në tregun e sigurimeve, komponent i realizuar i cili përfshiu:
  - o Metodologjinë e analizës mbikëqyrëse të parashikuar nga treguesit e rrezikut të sigurimit pas diagnostikimit;
  - o Përmirësimin e aftësisë së AMF për të vlerësuar disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e modeleve të biznesit të ndërmarra të sigurimeve;
  - o Zhvillimin e një qasje mbikëqyrëse efektive me shpërndarje të qartë të roleve.
- Zhvillimi i një Udhërrëfyese për zbatimin e Solvency II, komponent i cili përfshin:
  - o Procesin e vlerësimit të praktikave mbikëqyrëse të AMF-së kundrejt standardeve ndërkombëtare të sigurimeve, komponent i realizuar tashmë;
  - o Rishikimin e kornizës rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve dhe dhënien e rekomandimeve për fushat kryesore të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve – komponent i realizuar tashmë;
  - o Udhërrëfyesin mbi zbatimin e Solvency II, i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2022.
- Përmirësimi kuadrit rregullator dhe procedurave të falimentimit e likuidimit të kompanive të sigurimit, i cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2022. Ky komponent përfshinë:
  - o Rishikimin e procedurave të falimentimit dhe likuidimit të kompanive të sigurimit, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse;
  - o Këshillimin për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator;
- Rritja e besimit të konsumatorit në sigurime duke futur transparencën dhe llogaridhënien e subjekteve të sigurimit tek konsumatorët. Ky komponent do të përfshijë zhvillimin e një sistemi të monitorimit publik të cilësisë së shërbimit të siguruesve dhe performancës së kërkesë-ankesave, i cili do të finalizohet brenda dhjetor 2022 me përfundimin e projektit në tërësi.

### **“Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB / SECO – II”, Tregu i fondeve të pensioneve private**

Në kuadër të asistencës teknike të projektit “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare BB / SECO – II”, Banka Botërore ka rishikuar dhe ka dhënë komente teknike për projektligjin e ri për fondet e pensioneve private të përgatitur nga AMF.



Konsulenti i Bankës Botërore bëri një rishikim të përgjithshëm ligjor të projektligjit dhe ofroi të dhëna teknike për tema të tilla si:

- Stimujt për të rritur pjesëmarrjen në fondet e pensioneve vullnetare;
- Trajtimin e skemave të pensioneve profesionale;
- Politikat e investimit të fondeve;
- Alternativat e pagesës.

Ekipi i AMF-së dhe ekspertët e Bankës Botërore kanë diskutuar në vijimësi për të gjitha këto çështje.

### **Projekte me asistencë teknike të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare – FSVC**

Në kuadër të mbështetjes teknike që AMF përfiton nëpërmjet projekteve të ndryshme në bashkëpunim me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare e mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Autoriteti ka marrë pjesë në takimet *online* të projektit, “Për rritjen e kapaciteteve në kuadër të iniciativës ndërinstitucionale me fokus luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Vendet pjesëmarrëse ishin Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Shqipëria kishte pjesëmarrës nga Banka e Shqipërisë dhe nga AMF, si autoritete mbikëqyrëse, si edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si autoritet përgjegjës për luftën ndaj pastrimit të parave.

Në këndvështrimin e Task Forcës së Veprimit Financiar - FATF RBA (*risk based approach*), efektiviteti i një qasje bazuar në rrezik lidhet ngushtë me karakteristikat si në identifikimin e rrezikut ashtu edhe në zbatimin e përqasjes së rrezikut prej rolit të mbikëqyrjes.

Nëpërmjet kësaj iniciative, në takimet e realizuara, u krye prezantimi i një udhëzuesi i cili u fokusua në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut si dhe u diskutuan çështje të cila mbeten për t’u adresuar nga autoritetet shqiptare dhe për t’u rivlerësuar nga ekspertët e Komitetit të MONEYVAL të KiE-së.

### **Bashkëpunim me Sparkassenstiftung – DSIK Albania, mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim për hartimin e strategjisë së Edukimit Financiar**

“Sparkassenstiftung für Internationale Kooperation” është një agjenci zbatuese e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, e cila synon të rrisë aksesin, përdorimin dhe cilësinë e shërbimeve financiare në nivel global, duke mbështetur partnerë qeveritarë, joqeveritare dhe sektorët privatë në zbatimin e masave të përbashkëta të zhvillimit.

Gjatë vitit 2021, AMF ka bashkëpunuar me ekspertë të Sparkassenstiftung për hartimin e strategjisë së institucionit për edukim financiar. Grupi i punës në AMF dhe eksperti i projektit kanë diskutuar në takimet **online** duke vendosur prioritetet, grupet e synuara dhe iniciativat e përshtatshme për ti shërbyer rritjes së njohurive financiare. Në fund të vitit 2021 u hartua një draft i strategjisë, që do të vijojë të detajohet në vijim. Kjo strategji dhe grupi i punës në AMF do të bashkërendojnë punën edhe me institucionet e tjera financiare për rritjen e edukimit financiar.

#### **4.5 Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit**


AMF ka vijuar bashkëpunimin me **Bankën e Shqipërisë** edhe përgjatë vitit 2021. Ky bashkëpunim është shprehur si në projekte të përbashkëta, ashtu edhe në vijimësi të bashkëpunimeve ekzistuese. AMF është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave. Në takimin e zhvilluar në fund të vitit 2021, ku të pranishëm ishin edhe drejtues nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe institucionet e tjera, Grupi Këshillimor bëri vlerësimet mbi zhvillimet në institucionet dhe tregjet nën mbikëqyrje e tyre.

AMF, gjatë vitit 2021, ka bashkëpunuar me Bankën e Shqipërisë edhe në hartimin e draftit të parë të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar. Të dy institucionet po punojnë për hartimin e iniciativave të përbashkëta, që do të rrisin njohuritë financiare të publikut, si një mundësi për të marrë vendime të shëndetshme financiare.

AMF ka qenë pjesëmarrëse edhe në takimet për Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, KKSP, i cili synon të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri.

AMF ka vijuar kryerjen e inspektimeve të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë, për disa subjekte në tregjet financiare.

Zhvillimi i tregut të kapitaleve kërkon angazhimin e shumë pjesëmarrësve apo institucioneve me rol kyç në këtë treg. Për këtë arsye, Autoriteti është përfshirë në hartimin e një dokumenti strategjik për zhvillimin e tregut të kapitaleve, në bashkëpunim



me **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**. Dokumenti strategjik synon promovimin dhe zhvillimin e tregjeve efikase të kapitalit për një periudhë 5-vjeçare, duke synuar njëkohësisht edhe mbështetjen e rritjen e qëndrueshme ekonomike.

AMF dhe **Autoriteti i Konkurrencës** kanë vijuar komunikimet dhe bashkëpunimin në disa drejtime. AMF gjatë vitit 2021 ka vënë në dispozicion të këtij Autoriteti të gjithë informacionin e kërkuar. Gjithashtu, AMF ka komunikuar në vijimësi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti dhe **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)** kanë vijuar edhe gjatë vitit 2021 bashkëpunimin, të konkretizuar në disa fusha. Bashkëpunimi shtrihet si tek inspektimet e përbashkëta për subjektet nën mbikëqyrje, ashtu edhe në shkëmbimin e informacioneve për tregjet dhe subjektet nën mbikëqyrje.

## Kapitulli 5

### Mbrojtja Konsumatore dhe Transparenca me Publikun

#### 5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

Autoriteti, duke vepruar në përputhje me misionin e tij për nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e tregjeve financiare nën mbikëqyrje, është angazhuar për përmbushjen e qëllimit të tij për mbrojtjen konsumatore. Në këtë drejtim, veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2021 është orientuar drejt:

- Veprimeve parandaluese të pasqyruara në mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara, me qëllim përcaktimin e përputhjes së veprimtarisë së tyre me dispozitat ligjore dhe rregullatore;
- Regjistrave të personave juridikë dhe fizikë të autorizuar të cilat janë të disponueshëm në faqen e internetit të Autoritetit;
- Rritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet që lidhen me investimet në instrumente financiare, për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të mbikëqyrura dhe përdoruesve të shërbimeve të tyre;
- Edukimit të vazhdueshëm të përdoruesve të shërbimeve financiare duke përfshirë dhënien e informacionit përkatës në faqen e internetit, publikimin e rregulloreve përkatëse, tekstet edukative, buletinet, manualët dhe të dhënat mbi performancën e subjekteve të mbikëqyrura;
- Zhvillimit të përlogaritësit të dëmit në kontratat e sigurimit, i cili është ndërtuar në rastet e dëmit ndaj personit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

#### Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve është një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Autoritetit. Kjo i shërben jo vetëm forcimit të njohurive të konsumatorëve, por edhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve financiare për tregjet nën mbikëqyrje.


Gjatë vitit 2021, Autoriteti ka trajtuar 221 ankesa, kundrejt 151 ankesave të trajtuara në vitin 2020, me një rritje prej 46%. Pas ndërhyrjes së Autoritetit, janë zgjidhur me marrëveshje mes palëve rreth 58% e këtyre ankesave. Tregu i sigurimeve dominon me 97% të numrit të ankesave dhe sigurimi TPL është segmenti me numrin më të madh të ankesave (81%).





**Grafik 26. Ankesat sipas llojit të sigurimit**


(Në numër)



Në ankesat e depozituara mbizotërojnë ato me objekt dëmin material në masën 78% të totalit të ankesave.

**Grafik 27. Ankesat sipas llojit të dëmit**

(Në numër)




Autoriteti ka trajtuar gjithashtu ankesat që kanë të bëjnë me sigurimin e pronës, ku në krahasim me vitin 2020, viti pas tërmetit, vihet re një reduktim i ankesave të depozituara për vitin 2021, me 12 ankesa, kundrejt 33 që ishin në vitin 2020 për këtë kategori.

Shkaqet kryesore të ankesave gjatë vitit 2021 ishin:

- Refuzimi i kërkesës për dëmshpërblim;
- Vonesë e pagesës së dëmshpërblimit;
- Vonesë e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim;
- Shkaqe të tjera.

**Grafik 28: Ankesat sipas arsyes së ankimit**

*(Në numër)*



## 5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë

### Monitorimi i ndërmjetësve në tregun e sigurimeve

Gjatë vitit 2021, AMF ka monitoruar rast pas rasti nëpërmjet raportimeve periodike, apo verifikimeve në vend, zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregulatore të aktivitetit të agjentëve/punonjësve, kryesisht të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm TPL, si dhe shoqërive të brokerimit në sigurime. Pjesë e këtyre verifikimeve ka qenë edhe shqyrtimi i ankesave të depozituara në Autoritet.

AMF ka kryer analizën e pasqyrave financiare të ndërmjetësve në sigurime, me qëllim monitorimin në vazhdimësi të treguesve kryesorë të aktivitetit. Kështu, janë monitoruar tregues si kapitali, fondi i garancisë, mjetet monetare, rezultati financiar i aktivitetit, si dhe është bërë krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm i të ardhurave nga ndërmjetësimi. Këto rezultate janë raportuar në Bordin e Autoritetit, i cili ka dhënë vendimet përkatëse.



Nga analiza e pasqyrave financiare të ndërmjetësve në sigurime, për vitin 2020, rezultoi një shoqëri me mungesë kapitali, kërkesë e Ligjit nr. 52/2014, për të cilën Bordi i Autoritetit, kërkoi marrjen e masave për plotësimin e detyrimit ligjor. Kjo kërkesë u realizua nëpërmjet shtimit të kapitalit nga aksionarët e shoqërisë, brenda afateve të përcaktuara.

Autoriteti ka kryer dhe inspektime në vend pranë:

- 4 shoqërive, subjekte të tjera që kryejnë ndërmjetësim në sigurime, të cilat u inspektuan për herë të parë, që nga momenti i licencimit të tyre;
- 1 banke, broker në sigurime.
- 2 agjentëve individ në sigurime, nisur nga ankimet e depozituara në Autoritet;

Inspektimet kishin në fokus kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive dhe kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, si dhe respektimin e kërkesave ligjore e rregullatore në fuqi. Pas mangësive të konstatuara nga mbikëqyrja në vend, Bordi i Autoritetit mori masat përkatëse ndaj subjekteve.

### **Monitorimi i ndërmjetësve të tregut të kapitaleve**

Përveç monitorimeve të kryera nëpërmjet raportimeve periodike 3-mujore, gjatë vitit 2021, AMF zhvilloi inspektime në vend pranë një shoqërie, agjent i lidhur në tregjet e kapitalit. Nisur nga rezultati i inspektimit si dhe analiza e raportimeve, për arsye të ndërprerjes së kontratave me shoqëritë komisionere, Bordi i Autoritetit, vendosi pezullimin e aktivitetit dhe më tej heqjen e njohjes dhe çregjistrimin e agjentit të lidhur.

### **5.3 Edukimi Financiar**

Autoriteti, gjatë vitit 2021 ka vijuar punën për finalizimin e strategjisë së institucionit për “Edukimin Financiar”. Hartimi i kësaj strategjie, ndërtimi i prioriteteve dhe iniciativave është përputhur me një ndër objektivat parësor të Autoritetit, që është mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit. Strategjia ka nënvizuar grupet kryesore të synuara tek të cilat do të përqendrohet vëmendja e iniciativave dhe fushatave ndërgjegjësuese për të rritur njohuritë financiare për tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Në funksion të edukimit financiar të konsumatorit, stafi i Autoritetit është përfshirë në dy projekte “*Train of Trainers*” të zhvilluar nga donatorë të huaj, me qëllim përgatitjen e trajnerëve të ardhshëm, për të transmetuar te grupet e synuara, informacione dhe njohuri të dobishme në kuadër të edukimit financiar.

Rregullimi i mëtejshëm i procesit për organizimin e aktiviteteve për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim, ka bërë që gjatë vitit 2021 të jenë analizuar praktikat e sjella nga ofruesit e aktiviteteve, si dhe janë monitoruar trajnimet e zhvilluara për agjent në sigurime dhe agjent të fondeve SIK. Gjatë këtij viti Autoriteti ka zhvilluar një vizitë kontrolli tek një nga ofruesit e aktiviteteve, duke marrë një masë pezullimi dhe duke monitoruar në vijim plotësimin e detyrave të lëna.

Autoriteti ka zhvilluar trajnime për kualifikim profesional dhe edukim në vazhdim për profesionistët e tregjeve nën mbikëqyrje, për të kontribuar në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilësisë së lartë për konsumatorët dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve. AMF zhvilloi trajnimin **online** për vlerësues dëmsh në sigurime, me një pjesëmarrje prej 112 persona. Gjithashtu, për edukimin në vazhdim të profesionistëve në tregun e sigurimeve u zhvillua një trajnim për broker në sigurime.

Për një përgatitje sa më cilësore dhe profesionale të burimeve njerëzore në fushën e tregjeve financiare jobankare, Autoriteti ka shtrirë bashkëpunimin ndërinstitucional edhe me shoqatat e profesionistëve si dhe ka marrë pjesë në takimet e organizuara për edukim financiar nga Rrjeti Shqiptar për Edukimin Financiar.

#### **5.4 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun**

Komunikimi **online** përmes faqes web ka qenë një ndër format e përdorura më shumë për komunikimin publik nga Autoriteti. Tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen **online** të AMF-së ka vijuar edhe gjatë vitit 2021. Numri i klikimeve në faqen online arriti në 696.882 klikime me një rritje prej 9.21% krahasuar me një vit më parë. Faqja tërheq gjithnjë vizitorë të rinj dhe gjatë vitit 2021 ata zinin rreth 35% të totalit të vizitorëve. Mesatarisht një vizitor në faqe shikon rreth 3 nënseksione të saj, me një kohëzgjatje mesatare rreth 5 minuta për secilin nënseksion.


Faqja online e AMF-së është lehtësisht e aksesueshme në formatet e ndryshme teknologjike. Këtë e vërtetojnë edhe shifrat e klikimeve **online** të cilat tregojnë se rreth 71.7% e përdoruesve të faqes e kanë aksesuar atë nga **desktop**, ndër pjesa tjetër, prej rreth 28.3% e kanë vëzhguar faqen online nga aparatet e telefonisë celulare dhe **tablet**.

Duke ju referuar informacioneve të publikuara në faqen **online**, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga AMF, si edhe direktivat e ndryshme.



Grafik 29: Struktura e klikimeve në faqen *online* të AMF-së, 2021

(Në %)



Për t'i shërbyer edhe investitorëve apo analistëve të huaj, faqja *online* e AMF-së është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Të dyja formatet e faqes japin informacion për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private, fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si nga SHBA, Italia, Gjermania, Kosova.

#### Botimet e AMF-së të realizuara në vitin 2021

- Buletini Zyrtar
- Raporti Vjetor
- Raporti i Mbikëqyrjes
- Gjeografia e Sigurimeve

#### Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare
- Buletini Statistikor i tregut të fondeve të investimeve

## Kapitulli 6 Organizimi Institucional

### 6.1 Burime Njerëzore

Administrimi i burimeve njerëzore për vitin 2021 është orientuar drejt rritjes profesionale të punonjësve, qëndrueshmërisë së kapaciteteve administrative, si dhe përmirësimit të bazës rregullative.


Përmes praktikave më të mira të burimeve njerëzore është rishikuar rregullorja “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, duke krijuar në vazhdimësi mundësi promovimi për punonjësit me eksperiencë profesionale, si dhe duke synuar gjithmonë motivimin e punonjësve në nxitjen dhe ofrimin me njohuritë/praktikat profesionale, me qëllim rritjen e efektivitetit në punë.

Ruajtja e një mjedisi pune motivues për punonjësit, rritja e bashkëpunimit mes departamenteve, si dhe ndjekja e politikave të punësimit për ofrimin e mundësisë së promovimit, mbeten prioritet i Autoritetit.

Gjithashtu, një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe ruajtjes së raportit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti meshkuj-femra në nivel drejtues është 32% kundrejt 68% si dhe moshë mesatare e stafit është 41 vjeç.

**Grafik 30: Ndarjet funksionale sipas departamenteve**


(Në %)





**Grafik 31: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës**

(Në numër)



### **Vazhdimësia operationale në kushtet e pandemisë Covid-19**

Organizimi i punës në kushtet e vijimit të pandemisë, edhe gjatë vitit 2021, u përshtat duke kombinuar punën në zyrë me punën në distancë. Njësia e burimeve njerëzore, në këtë proces, u përball me ridimensionimin e planit për organizimin e punës dhe menaxhimin e stafit. Qëllimi kryesor ishte kryerja e praktikave të përditshme të punës për të ruajtur shëndetin dhe mirëqenien e stafit dhe njëkohësisht për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit nëpërmjet mekanizmave të raportimit dhe kontrollit të detyrave.

### **Kualifikimi profesional**

Duke vlerësuar rëndësinë e aftësive profesionale të punonjësve në ekzekutimin me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka nxitur dhe ka mundur realizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të rëndësishme profesionale të punonjësve. Edhe gjatë vitit 2021, programi i trajnimeve, ka patur një larmi të tematikave. Pjesëmarrja e punonjësve të Autoritetit në trajnime nëpërmjet webinarëve ka qenë e vazhdueshme dhe është realizuar në distancë, ndikuar edhe nga situata e pandemisë Covid-19. Gjatë vitit 2021, rreth 51% e stafit teknik ka ndjekur aktivitete trajnuese.

Aktivitetet konsistojnë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira profesionale me autoritetet homologe, institucionet financiare si dhe me shoqatat ndërkombëtare të regullatorëve, duke vijuar ritjen e produktivitetit të punës në Autoritet.

Gjithashtu, për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, stafi i Autoritetit ka marrë pjesë edhe në aktivitete në vend, në bashkëpunim me projektet e ndryshme me institucione të huaja.


## 6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2021 janë kryer zhvillime në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese, kryesisht bazuar në nevojat e planifikuara, por edhe si rezultat i nevojave të tregjeve nën mbikëqyrje dhe ndryshimeve ligjore të ndodhura në vitin 2021.

### Aktivitetet kryesore të ndodhura gjatë vitit 2021 përfshijnë:

- Ndjekja dhe zbatimi i politikave të sigurisë së informacionit, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së;
- Ofrimi i shërbimeve **online** (portali E-Albania) me qëllim aksesin e konsumatorit për t'u informuar në kohe reale në lidhje me statusin e produkteve që blen nga tregu i sigurimeve për rritjen e besimit ndaj tregut;
- Përditësimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (AMF In-Reg), sistem i cili përfshin raportimet financiare dhe treguesit financiarë për tregun e sigurimeve, në versionin e ri. Trajnimin e staftit kyç prej 10 specialistësh që përdor këtë sistem me modulën e plotë të trajnimit të ofruar nga kompania që ka ndërtuar këtë sistem;
- Përmirësime dhe zhvillime të mëtejshme në Regjistrin **Online** të Shitjeve dhe në Sistemin e Dëmeve, sipas nevojave të tregut dhe ndryshimeve në Rregulloren e Shitjeve **online** të produkteve të detyrueshme në tregun e sigurimeve sipas përcaktimeve në Ligjin 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit";
- Zhvillimi i sistemit të ankesave (CRM) në ofrimin sa më të thjeshtë të informacionit ndaj palëve të treta si dhe monitorimin apo përmirësimin e raportimit të ankesave **online**;
- Përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të raportimit financiar për tregun e fondeve të investimeve dhe pensioneve në kuadër të ofrimit të integritetit më të thjeshtë të shoqërive;
- Përditësimi i faqes zyrtare online të AMF-së me shërbime të reja për publikun, si dhe përmirësimin e rubrikës së transparencës;
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit kompjuterik qendror në AMF, si dhe në sistemet e ruajtjes pranë AKSHI (**backup**).





### 6.2.1 Sistemi i Raportimit Online

Sistemi AMF In-Reg është një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës shoqëritë e sigurimit raportojnë të dhënat financiare të kërkuara nga Autoriteti. Gjatë vitit 2021 u mundësua krijimi i një ambienti bashkëkohor i përditësuar në një version më të ri. Ky version mundëson një shkallë më të lartë sigurie, një përditësim me teknologjinë e fundit si dhe ofrimin e funksioneve të reja.

Krahas përditësimit të këtij sistemi, u realizua njëkohësisht trajnimi **online** i 10 specialistëve për të gjitha modulet e ofruara nga kompania zhvilluese e këtij sistemi me qëllim që ata jo vetëm të jenë të aftë të lexojnë e interpretojnë raportet që gjenerohen, por të ndërtojnë raporte të reja të cilat i shërbejnë nevojës për informacion për të gjitha nivelet drejtuese.

### 6.2.2 Digjitalizimi i shërbimeve në portalin e-Albania

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim lehtësimin e procedurave të qytetarëve, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për t'u pajisur me informacionet apo vërtetimet e nevojshme në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve, ka mundësuar ofrimin e disa shërbimeve elektronike në kohë reale nëpërmjet portalit e-Albania.

Shërbimet janë të aksesueshme në e-Albania për çdo policëmbajtës të interesuar. Policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, raportohen në kohë reale në Regjistrin Online të AMF-së, i cili në ndërveprim me e-Albania u mundëson qytetarëve të verifikojnë po në kohë reale policën e tyre të sigurimit të detyrueshëm.

Të gjithë qytetarët që zotërojnë një policë të sigurimit të detyrueshëm motorik (TPL dhe Karton Jeshil), mund të informohen si edhe të marrin dokumentacionin e nevojshëm të pajisur me nënshkrimin elektronik, gjeneruar nga e-Albania, lidhur me:

- Vlefshmërinë e policës së sigurimit;
- Historikun e sigurimit të mjeteve në pronësi të qytetarit;
- Historikun e dëmeve të mjeteve motorike;
- Njoftimin për përfundimin e afatit të policës së sigurimit.

### 6.2.3 Regjistri Elektronik "Online" i Sigurimit të detyrueshëm motorik

Përshtatja e Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm u realizua dhe në kuadër të nenit 31, pikat 1/a, 1/c, 4 dhe 7, të Ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e

detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke përditësuar **webservice** në mënyrë që çdo produkt të jetë i ndarë në akses nga shoqëritë. Kjo matricë bën të mundur konfigurimin e shoqërive dhe produkteve që ato ofrojnë.

Në zbatim të ndryshimeve ligjore dhe përditësimit të webservice-it u hartua dhe Rregullorja e re Nr. 159 datë 29.09.2021 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve në tregun e sigurimeve”, e cila saktëson të gjitha procedurat që duhet të ndjekin përdoruesit e këtij regjistri për të garantuar jo vetëm hedhjen saktë dhe sipas detyrimeve ligjore të produkteve që shiten e raportohen në kohë reale, por dhe për të garantuar sigurinë e të dhënave që përmban ky regjistër.

### **6.3 Auditimi i Brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka orientuar aktivitetin në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar me Vendim Bordi nr. 191, datë 16.12.2020.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një auditues të teknologjisë së informacionit. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Auditimi u përqendrua kryesisht në fushat e vlerësuara si me nivel të lartë rreziku nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Cilësia e auditimit konsiderohet jo vetëm faktor i rëndësishëm në prezantimin e auditimit (raportit) dhe rezultateve të tij: opinionit, konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve; por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së audituesve gjatë auditimit dhe njësive të audituara për zbatimin e rekomandimeve.

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2021 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme për funksionet dhe proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve. Tregues kryesor i ndikimit të punës audituese është ndryshimi pozitiv që auditimi i brendshëm sjell nëpërmjet rekomandimeve mbështetur në analiza dhe vlerësimeve të sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të rrezikut dhe përmirësimin e proceseve në të ardhmen.



Gjatë vitit 2022 drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në objektivat e mëposhtme:

- Plotësimi i bazës rregullatore, i procesit të përshtatshmërisë dhe ligjet e reja;
- Përafrimi me standardet më të mira ndërkombëtare në praktikat mbikëqyrëse;
- Zhvillimi i tregjeve nën mbikëqyrje;
- Monitorimi i treguesve financiarë dhe subjekteve nën mbikëqyrje;
- Përmirësimi i sistemeve të raportimit dhe digjitalizimi.

### **1. Plotësimi i bazës rregullatore, i procesit të përshtatshmërisë dhe ligjet e reja**

Autoriteti do të vijojë me miratimin e rregulloreve të reja në zbatim të tregjeve të kapitalit, me asistencën e ekspertëve të Bankës Botërore, pjesë e projektit “Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve” (SECO II).

Projektligji “Për fondet private të pensionit”, pas konsultimit publik, do të kalojë fazat deri në miratimin e tij. Autoriteti do të angazhohet gjithashtu në procesin e hartimit dhe miratimit të të gjithë kuadrit të nevojshëm rregullator.

Gjatë vitit 2022 do të vijojë puna e Autoritetit për përfundimin e përshtatshmërisë së subjekteve të tregjeve të kapitalit, si edhe të fondeve të investimit, në përputhje me kërkesat e ligjeve të reja dhe bazës rregullative në fuqi.

### **2. Përafrimi me standardet më të mira ndërkombëtare në praktikat mbikëqyrëse**

Gjatë vitit 2022 prioritet i Autoritetit është forcimi i mëtejshëm i funksionit mbikëqyrës dhe përafrimi me standardet më të mira ndërkombëtare. Në kuadër të projektit të asistencës të financuar nga SECO, do të përfitohet ekspertizë si për tregjet e kapitalit, ashtu edhe për tregun e sigurimeve.

Sa i përket tregut të sigurimeve, Autoriteti i asistuar nga ekspertët e Bankës Botërore është angazhuar në rishikimin e metodologjisë mbikëqyrëse në tregun e sigurimeve. AMF, në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore, do të realizojë një vlerësim të plotë të përputhshmërisë me Parimet Themelore Ndërkombëtare në Sigurime (Insurance Core Principles - ICP), me qëllim avancimin drejt standardeve më të mira ndërkombëtare. Pjesë e planit të punës është edhe zhvillimi i një udhërrëfyesi të nivelit të lartë në kuadër të përafrimit me regjimin evropian Solvency II, si edhe rishikimi i kornizës rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve.

Në lidhje me tregun e fondeve të investimeve, AMF është drejt finalizimit të Manualit të Mbikëqyrjes me bazë rrezikun për sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), mbështetur në draftmanualin e ekspertëve të projektit. Gjithashtu, pjesë e projektit dhe asistencës ndërkombëtare janë edhe tregjet e kapitalit, ku Autoriteti po punon në drejtim të përmirësimit të sistemit të mbikëqyrjes, hartimit të procedurave dhe manualeve të inspektimit, si edhe zbatimit të masave mbikëqyrëse.

### **3. Zhvillimi i tregjeve nën mbikëqyrje**

Gjatë vitit 2022 Autoriteti do të vijojë rolin e tij proaktiv në funksion të mirëregullimit dhe zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje.

Kështu gjatë vitit 2022 në fokus të tij do të jetë finalizimi dhe implementimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit. Për arritjen e këtij objekti Autoriteti do të vijojë bashkëpunimin me institucionet me rol kyç për zhvillimin e tregut si dhe me aktorët e tregut apo institucione ndërkombëtare.


Ligji i ri për fondet private të pensioneve synon t'i japë një ritëm të ri zhvillimi këtij tregu. Gjithashtu, ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe SIK kanë zgjeruar dhe diversifikuar mundësitë e investimit për investitorët shqiptarë.

### **4. Monitorimi i treguesve financiarë dhe subjekteve nën mbikëqyrje**

Autoriteti do të vijojë mbikëqyrjen e kujdesshme të tregjeve dhe treguesve kryesorë financiarë të subjekteve nën mbikëqyrje, marrë në konsideratë efektet si pasojë e ndikimeve të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm.

Gjithashtu, sa i përket mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, fokus të veçantë do t'i kushtohet edhe monitorimit të dëmeve, ku përfshihen inspektime tematike. Synohet realizimi i kolegeve mbikëqyrëse të shoqëritë e sigurimit ku janë të përfshira shoqëritë austriake të sigurimit. Në funksion të zbatimit të rregullores për komisionet e ndërmjetësimit do të monitorohet raportimi financiar dhe verifikimi në vend.

Do të vijohet me monitorimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për të mbajtur nën vëzhgim situatën me Fondin e Kompensimit, si edhe daljes së mundshme të Byrosë nga monitorimi. Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve, AMF do të vijojë monitorimin e treguesve teknikë dhe financiarë të shoqërive administruese dhe të fondeve përmes raportimeve dhe analizave financiare.




## **5. Përmirësimi i sistemeve të raportimit dhe digjitalizimi**

Gjatë vitit 2022, AMF synon të vijojë përmirësimin e sistemeve të brendshme, si edhe sistemeve të raportimit për tregjet nën mbikëqyrje. Në këtë kuadër do të synohet përmirësimi i mëtejshëm i politikave të sigurisë për Qendrën e Informacionit të Sigurimit të Detyrueshëm, si edhe për sistemet e tjera që administrojnë AMF.

Autoriteti do të realizojë zhvillime dhe përmirësime të mëtejshme në regjistrin online të shitjeve, si edhe në sistemin e dëmeve, përsa i përket sigurimit të detyrueshëm motorik.

Pas realizimit të përditësimit të sistemit të raportimit AMF In-Reg, gjatë vitit 2022 Autoriteti do të angazhohet në krijimin e raporteve të reja analitike në funksion të një mbikëqyrje sa më efektive të tregut të sigurimeve. Gjithashtu, AMF do të angazhohet në përmirësimin e mëtejshëm edhe të sistemit të raportimit financiar për tregun e fondeve të investimeve dhe pensioneve private.

**SHTOJCA A**  
**STRUKTURA ORGANIZATIVE E AMF-SË, 2021**





## mazars

### **Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Institucioni) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondet e veta dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Institucioni në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Institucionit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Institucionit, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit.


### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Institucionit për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Institucionit për vijimësi.





- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Institucionit, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

21 mars 2022



---

**Teit Gjini**  
Auditues Ligjor

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

### Më 31 dhjetor 2021

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>AKTIVE</b>		
<b>Aktivet afatgjata</b>		
Aktivet afatgjata materiale	60,029,405	68,673,299
Aktivet afatgjata jomateriale	26,015,998	25,617,511
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>	<b>86,045,403</b>	<b>94,290,810</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		
Llogari të arkëtueshme	43,581,948	39,767,211
Paradhënie dhe të ardhura të përlogaritura	1,669,095	607,141
Garanci të dhëna	463,580	463,580
Investime ne depozita dhe Bono Thesari	154,470,508	58,337,000
Mjetet monetare në arkë e në bankë	83,067,463	135,954,935
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>283,252,594</b>	<b>235,129,867</b>
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>369,297,997</b>	<b>329,420,677</b>
<b>KAPITALI</b>		
Fonde bazë	119,287,505	119,287,505
Rezerva	174,328,000	173,988,000
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>293,615,505</b>	<b>293,275,505</b>
<b>DETYRIMET</b>		
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Llogari të pagueshme	2,108,825	876,495
Detyrime për tatim taksa	7,814,082	7,612,581
Detyrime ndaj shoqërive të sigurimit	44,046,283	3,796,671
Të tjera të pagueshme	480,000	2,626,123
Fondi i provizionit	21,233,302	21,233,302
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>75,682,492</b>	<b>36,145,172</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>75,682,492</b>	<b>36,145,172</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>	<b>369,297,997</b>	<b>329,420,677</b>



Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Nga njësi ekonomike publike dhe private financiare	296,525,582	293,959,685
Gjoha dhe kamatëvonesa, sekuestriime e zhdëmtime	7,100,000	450,000
<b>Total të ardhura</b>	<b>303,625,582</b>	<b>294,409,685</b>
Shpenzime korrente	(233,701,000)	(221,395,912)
Mallra dhe shërbime të tjera	(48,765,295)	(44,856,456)
Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara	(17,950,407)	(20,295,080)
<b>Total shpenzime</b>	<b>(300,416,702)</b>	<b>(286,547,448)</b>
Të ardhura nga interesat e depozitave	882,440	230,163
Shpenzime nga këmbimet valutore	(3,751,320)	796,600
<b>Rezultati i vitit</b>	<b>340,000</b>	<b>8,889,000</b>

